

# RAPORT VJETOR

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
Komuna e Dragashit  
Opština Dragaš

01 Nr. Br. 067/01-7892/26  
04.03.2026  
Dragash - Dragaš

PUNA E KRYETARIT DHE ORGANEVE EKZEKUTIVE  
TË KOMUNËS SË DRAGASHIT PËR VITIN 2025

MARS 2026



---

## Kryetari i Komunës

Qytetarë të Komunës së Dragashit,

Bazuar në ligjin për vetëqeverisje lokale Nr.03/L-040 dhe Statutin e Komunës së Dragashit 01nr.06-103/1 i datës 11.09.2008, kam nderin dhe kënaqësinë që para jush të paraqes raportin vjetor janar – dhjetor 2025 për te arriturat, sukseset, angazhimet por edhe sfidat dhe vështirësitë me të cilat është përballur Komuna e Dragashit gjatë vitit 2025.

Si rezultat i punës së përbashkët dhe bashkëpunimit të mire brenda dhe jashtë institucionit, kemi arritur që të kryejmë pjesën më të madhe të objektivave, aktiviteteve si dhe detyrave sipas planifikimeve strategjike dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Që të jetë sa ma transparent për publikun, Komuna e Dragashit përmes këtij dokumenti ka ofruar një pasqyrë të përgjithshme të aktiviteteve të saj, për t'iu dhënë mundësi qytetareve që të njohin dhe vlerësojnë punën e institucioneve komunale.

Puna e Kryetarit, përkatësisht ekzekutivit të Komunës së Dragashit, është zhvilluar përmes 8 drejtorive dhe shërbimeve përcjellëse të Komunës, në harmoni me legjislacionin, udhëzimet dhe Statutin e Komunës.

### Synimet politike ne qeverisje:

- Qeverisje të mirë, të përgjithshme, të qëndrueshme, të hapur me qytetarët, demokratike dhe të suksesshme;
- Qeverisje me plane dhe shikim kah e ardhmja;
- Qeverisje që gjen zgjidhje, sado sfiduese dhe komplekse të jenë problemet;
- Qeverisje me plane të qarta dhe ambicioze;
- Qeverisje që përballlet me guxim dhe kryen pune me dinamike të lartë e nuk vonohet;
- Qeverisje që vlerëson, motivon dhe mbështet talentin dhe të arriturat e qytetareve tanë të të gjitha shtresave;
- Qeverisje ndërtuese që promovon përfshirjen në vendimmarrje të forcave me ndikim në shoqëri, si: forcat politike, Kuvendin e Komunës, bashkësinë fetare, shoqërinë civile, bizneset, individët, të rinjtë dhe grupet e ndryshme të interesit;
- Qeverisje energjike që mobilizon resurse dhe përfshinë në veprime investuese e zhvillimore punën në partneritet;
- Qeverisje për të gjithë pa dallim.

---

## Aktivite të rëndësishme (GJASHTËMUJORI I PARË)

- Edhe përgjatë këtij viti, kemi vazhduar bashkëpunimin e ngushtë me institucionet dhe përfaqësitë diplomatike ndërkombëtare. Kemi pritur për një vizitë me rëndësi ambasadorin e Britanisë së Madhe, Jonathan Hargreaves;
- Gjithashtu, kemi pritur edhe ambasadorin e Republikës së Turqisë, Sabri Tunç Angili;
- Kemi pasur takim edhe me komandantin e KFOR-it nga Komanda Rajonale Perëndim, Kolonel Francesco Errico, me të cilin kemi diskutuar lidhur me situatën e sigurisë dhe çështje që prekin interesin e përgjithshëm të qytetarëve;
- Kemi zhvilluar takime dhe kemi formalizuar Marrëveshjen me Projektin HELVETAS/DEMOS, për bashkëpunimin dhe konsultimin lidhur me organizimin e takimeve buxhetore dhe rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje;
- Nën organizimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Institutit për Planifikim Hapësinor, kemi marrë pjesë në takimin publik lidhur me shqyrtimin e Draftplanit Hapësinor të Parkut Kombëtar Sharr dhe Drafraportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Planin Hapësinor në Parkun Kombëtar Sharr, ku kemi paraqitur kërkesat tona dhe të qytetarëve, të cilat kanë të bëjnë me rritjen e mundësive për zhvillimin e përgjithshëm ekonomik dhe turistik të Komunës sonë;
- Në fushën e përfaqësimit gjinor në institucionet publike, këtë vit kemi shënuar edhe një hap tutje, ku kemi emëruar edhe dy gra në pozita udhëheqëse: zëvendësdrejtoreshën e QKMF-së, e cila për më tepër është edhe nga komuniteti joshumicë, si dhe drejtoreshën e Çerdhes në Dragash;
- Në bashkëpunim me partnerët tanë, kemi filluar edhe realizimin e Porjektit të Papa Testit pa pagesë për të gjitha gratë e Komunës sonë, një iniciativë kjo e Grupit të Grave Asambleiste. Ky përbën një hap të rëndësishëm në drejtim të përmirësimit të shërbimeve shëndetësore;
- Në këtë drejtim, gjithashtu kemi filluar edhe programin e vizitave sistematike shëndetësore nëpër shkollat e Komunës së Dragashit, për nxënësit e klasave të para dhe të pesta, një program i realizuar me sukses nga profesionistët tanë shëndetësorë;
- Në kuadër të vizitës studimore të realizuar nga Asambleja Komunale, si kryetar i Komunës, së bashku me Kryesuesen e Kuvendit kam realizuar një takim me kryetarin e Komunës Purkersdorf të Austrisë, me të cilin kemi dakorduar që të thellojmë bashkëpunimin ndërmjet komunave tona, me theks të veçantë në binjakëzimin ndërmjet komunave;
- Për këtë qëllim, ne kemi kaluar procedurat fillestare në Kuvendin e Komunës, ku delegatët me shumicë votash kanë votuar për nisjen e procedurave të binjakëzimit;
- Gjithashtu, Komuna e Dragashit tashmë edhe zyrtarisht është binjakëzuar edhe me Komunën e Mavrovë-Rostushës nga Maqedonia e Veriut, gjatë ceremonisë e cila u zhvillua me rastin e Ditës së Çlirimit të Dragashit;

- Me partnerët nga HELVETAS/DEMOS kemi finalizuar nënshkrimin e Marrëveshjes për Mbështetje Financiare të projektit "Asfaltimi i rrugëve dhe kubëzimi i rrugëve në regjionin e Gorës në Dragash (fshatrat Restelicë dhe Radeshë)", nga Skema e Grantit për Performancë Komunale;
- Kemi pasur edhe një vizitë me rëndësi nga Përfaqësuesja Speciale e Sekretariatit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, znj.Caroline Ziadeh, ku kemi diskutuar për bashkëpunim e ndërsjellë dhe mbështetjen e ofruar nga UNMIK-u, veçanërisht në zbatimin e projekteve, siç janë Papa Testi dhe përmirësimi i shërbimeve dentare në QKMF, me theks të veçantë për personat me nevoja të veçanta;
- Kemi nënshkruar Marrëveshjen e Bashkëpunimit për Kryerjen e Shërbimeve Postare ndërmjet Komunës së Dragashit, Policisë së Kosovës dhe Postës së Kosovës;
- Gjithashtu, kemi pasur nderin që t'i presim në një takim miqësor përfaqësuesit e organizatave të dala nga lufta, me të cilët kemi pasur një bashkëbisedim të frytshëm rreth ecurisë së bashkëpunimit dhe mbështetjes që Komuna jonë në vazhdimësi ka ofruar për OVL-në e UÇK-së në Dragash;
- Kemi pasur takime edhe me përfaqësues të fshatrave dhe institucioneve shëndetësore nga fshatrat kufitarë të Shqipërisë, si Zapodi, Pakishta etj., me të cilët kemi diskutuar lidhur me shërbimet shëndetësore falas dhe trajtimin e barabartë që Komuna E Dragashit ua bën qytetarëve nga Shqipëria;
- Së bashku me kryesuesen e Kuvendit, kemi zhvilluar një vizitë tek humanisti Halil Kastrati, ku kemi folur rreth mundësisë së thellimit të bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Dragashit dhe shoqatës "Jetimat e Ballkanit" të cilën drejton humanisti Halil Kastrati. Ky bashkëpunim do të fokusohet në mbështetjen e ofruar për qytetarët e Komunës sonë, me theks të veçantë në ndërtimin e shtëpive të banimit për njerëzit në nevojë, ku shoqata "Jetimat e Ballkanit" dhe Komuna e Dragashit do të jenë bashkëfinancuese;
- Me Ministrinë e Zhvillimi Rajonal kemi vazhduar bashkëpunimin, ku gjatë këtij muaji kemi pritur në takim ministrin e MZHR-së, z.Fikrim Damka, me të cilin kemi diskutuar lidhur me thellimin e bashkëpunimit, konkretisht në mbështetjen financiare që MZHR-ja do të na ofrojë në realizimin e disa projekteve kapitale;
- Në fillim të këtij viti kemi marrë edhe një vendim të rëndësishëm: Komuna e Dragashit ka marrë përsipër pagesën e shpenzimeve të ndriçimit publik për të gjitha fshatrat të cilat e kanë të instaluar ndriçimin;
- Gjithashtu, kemi bërë edhe përrurimin e rrjetit të ndriçimit publik në fshatrat Brrut dhe Pllavë;
- Si qeverisje lokale, kemi marrë pjesë në të gjitha manifestimet për ditët e shkollave në të gjitha shkollat fillore dhe në Shkollën e Mesme "Ruzhdi Berisha".

## (GJASHTËMUJORI I DYTË)

- Bashkë me organizatën partnere IOM dhe me financimin e BE-së, kemi bërë hapjen e Kabinetit të ri të Infermierisë në Gjimnazin “Ruzhdi Berisha”, një mundësi e mirë për të ngritur cilësinë e mësimdhënies dhe për të lehtësuar mësimnxënien praktike të nxënësve;
- Së bashku me përfaqësues të Qeverisë Lokale, kemi zhvilluar një vizitë zyrtare në Bashkinë e Lezhës në Republikën e Shqipërisë, ku kemi shqyrtuar shkëmbimin e eksperiencave dhe mundësitë e bashkëpunimit mes dy institucioneve tona;
- Me Universitetin “Ukshin Hoti” në Prizren kemi nënshkruar Marrëveshjen e Bashkëpunimit me qëllim të mbështetjes së organizimit të Shkollës Verore Ndërkombëtare 2025;
- Në muajin korrik kemi filluar njërin nga projektet më të rëndësishme të Komunës sonë për stabilizimin e furnizimit me energji elektrike: ndërtimin e rrjetit TM 10(20) kV dhe TU 04 kV në segmentin Globoqicë-Krushevë-Restelicë, si dhe rrjetit TM 10(20) kV dhe TU 04 kV në drejtim të fshatit Brod. Vlera e përgjithshme e projektit është rreth 800,000 euro, ku 45% e mjeteve janë siguruar nga komuna, ndërsa pjesa tjetër prej 55% është financuar nga KEDS;
- Gjithashtu, në fshatin Restelicë kemi bërë hapjen e objektit për depozitimin e mbeturinave, i cili është financuar nga Qeveria Japoneze përmes Programit GGP (Grante për Projekte për Sigurinë Bazike Njerëzore);
- Në fshatin Krushevë kemi hapur objektin e ri të Qendrës së Mjekësisë Familjare, duke sjellur shërbimet jetike shëndetësore më afër qytetarëve, veçanërisht për komunitetin joshumicë që jetojnë në këtë pjesë të Komunës së Dragashit. Ndërtimi i kësaj qendre moderne është financuar nga buxheti vetanak i Komunës së Dragashit, ndërsa aparatura dhe pajisjet janë siguruar falë bashkëpunimit të shkëlqyer me Agjencinë Turke për Zhvillim dhe Bashkëpunim (TIKA);
- Kemi bërë lansimin e programit për Rrobaqepësi, një iniciativë që synon fuqizimin e grave dhe vajzave të Komunës sonë, përmes aftësimin profesional dhe krijimit të mundësive të reja për punësim. Ky projekt implementohet ngë OJQ “AVOKO” dhe është financuar nga Kryesia e Këshillit Turk në Kosovë, përmes Njësisë së CIMIC-ut dhe me mbështetjen e LMT-së në Dragash;
- Në bashkëpunim me “Ekoregjionin”, kemi përfshirë në sistem dhe kemi filluar grumbullimin e mbeturinave nga të gjitha fshatrat e Komunës së Dragashit;
- Në Kuadër Të Projektit qeveritar “Banimi Social Adekuat”, kemi hapur Thirrjen publike për Renovimin/Rindërtimin e Shtëpive Private Për Familjet e Cenueshme;
- Në bashkëpunim dhe me mbështetjen e LMT-së së KFOR-it Turk në Dragash, kemi bërë hapjen dhe trasimin e rrugës Rrenc-Xërxe;
- Gjithashtu, kemi bërë edhe demolimin e objektit të vjetër të shkollës në fshatin Bellobrad;
- Me OJQ-të BIRN dhe AVOKO kemi nënshkruar Marrëveshjen e Bashkëpunimit për zbatimin e Programit të Auditimit Social të katër projekteve të financuara nga Granti i Performancës;
- Nga muaji gusht i këtij viti, Komuna e Dragashit ka filluar mbulimin e shpenzimeve të energjisë elektrike për pompat e ujit në të gjitha fshatrat që furnizohen me ujë të pijshëm përmes tyre,

---

një hap ky i rëndësishëm për lehtësimin e barrës financiare të shpenzimeve mujore për qytetarët tanë;

- Nga CIMIC-u italian i KFOR-it kemi pranuar një kontigjent të mjeteve teknike për Shërbimin e Zjarrfikësve në Komunën tonë, të cilat do të kontribuojnë në rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve që ofron kjo Njësi;
- Me Agjencinë Kadastrale të Kosovës kemi vazhduar bashkëpunimin për Projektin për Rindërtimin e Kadastrit, një iniciativë kjo e një rëndësie të veçantë për zgjidhjen e çështjeve pronësore të trashëguara ndër dekada për Zonat Kadastrale: Dragash, Leshtan, Bresanë dhe Pllajnik;
- Në nderim të jetës dhe veprës së veprimtarit Samidin Muhametit – Babait, sheshin te Pazari i Vjetër në fshatin Bresanë e kemi emërtuar: Sheshi “Samidin Muhameti – Babai”;
- Me rastin e Ditës Botërore të Pastrimit, edhe në Komunën e Dragashit kemi zhvilluar aktivitete të pastrimit të hapësirave publike, në bashkëpunim me organizatën "Let's Do It - Ta Pastrojmë Kosovën", duke realizuar kështu një fushatë të suksesshme për ngritjen e vetëdijes mbi rëndësinë që ka një mjedis i pastër në shëndetin publik;
- Në bashkëpunim me Komitetin Olimpik të Kosovës, kemi organizuar aktivitetin tradicional sportiv “Vrapimi i Gjeneratës së Pavarësisë së Kosovës (2008)”, i cili u mbajt në Stadiumin e Qytetit në Dragash;
- Në shtator të këtij viti kemi organizuar edicionin e 4-të me radhë të Panairit me Produkte Vendore Lokale "EXPO SHARRI". Edhe ky edicion i kësaj ngjarjeje tashmë tradicionale ekonomike mbledhi së bashku prodhuesit lokalë, afaristët, institucionet dhe qytetarët, duke u shndërruar në një platformë të rëndësishme për promovimin e produkteve vendore dhe fuqizimin e zhvillimit ekonomik të komunës sonë;
- Në oborrin e QKMF-së në Dragash kemi hapur qendrën e hapur të fitnesit, një projekt ky i financuar nga Ambasada e Bullgarisë dhe implementuar nga Komuna e Dragashit dhe OJQ UBUGK. Kjo qendër do të shërbejë si një hapësirë sportive dhe rekreative për qytetarët e të gjitha komuniteteve që jetojnë në Komunën tonë;
- Po ashtu, në muajin tetor të këtij viti kemi bërë përrurimin e Çerdhes së fëmijëve në Dragash, pas një pune dhe angazhimi të palodhshëm. Ky institucion i rëndësishëm do t’u mundësojë fëmijëve tanë edukim dhe kujdes cilësor që në hapat e parë të jetës, ndërsa prindërve do t’ua lehtësojë përditshmërinë;
- Përmes Zyrës për Barazi Gjinore dhe në bashkëpunim me FSK-në, në kuadër të shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Vajzave kemi organizuar aktivitete me qëllim vetëdijesimin për rolin e vajzave dhe grave në shoqëri, si dhe promovimin e mundësive për karrierë në Forcën e Sigurisë së Kosovës;
- Në kuadër të aktiviteteve për Muajin Rozë, janë organizuar ligjëratat vetëdijesuese lidhur me zbulimin dhe parandalimin e hershëm të kancerit të gjirit;
- Me Agjencinë e Pyjeve të Kosovës, Agjencionin për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës dhe Drejtorinë për Administrimin e Parkut Kombëtar "Sharri", kemi nënshkruar Memorandumin për


bashkëpunim në monitorimin dhe menaxhimin e pyllëzimeve dhe infrastrukturës përcjellëse në Zonën Kadastrale Restelicë, zonën e pyllëuar me mbështetjen e organizatës japoneze JICA;

- Në shtator të këtij viti kemi përfunduar njërin nga projektet më të mëdha kapitale në historikun e Komunës sonë: Ujësjetësin për 15 fshatra dhe qytezën e Dragashit, duke shënuar kështu një hap të rëndësishëm në drejtim të përmirësimit të mirëqenies për qytetarët tanë;

- Edhe këtë vit kemi vazhduar ndarjen e bursave për studentët dhe studentet e Komunës sonë. Nga ky program kanë përfituar gjithsej **110 studentë, me një shumë totale prej 50 mijë eurosh (454.54€ për student)**;
- Gjatë vitit 2025, nga subvencionet në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit kanë përfituar gjithsej **20 OJQ, me një shumë totale prej 147 mijë euro**;
- Sa u përket investimeve kapitale, gjatë vitit 2025 kemi nënshkruar **106 kontrata për projekte të ndryshme, me një vlerë totale 4,483.115 €**;
- Kemi marrë gjithsej **318 vendime për ndarjet të mjeteve për shërim**, ku kanë përfituar **153 gra dhe 165 burra**;
- Nga subvencionet për Bujqësi gjatë vitit 2025 kanë përfituar gjithsej **248 fermerë me një shumë totale prej 87,148 €**.

## Investimet Kapitale

Sa u përket investimeve kapitale, Komuna e Dragashit përgjatë vitit 2025 e ka realizuar në masë të konsiderueshme Planin e Prokurimit. Kemi nënshkruar **mbi 100 (106) kontrata për realizimin e projekteve** të ndryshme nëpër të gjithë territorin e Komunës sonë, të cilat lidhen kryesisht me modernizimin e infrastrukturës publike nëpër institucione shëndetësore dhe arsimore, kubëzimin dhe asfaltimin e rrugëve lokale, ndërtimin e infrastrukturës sportive etj. Vlen të përmendet se gjatë vitit 2025 ka përfunduar edhe njëri nga projektet më të mëdha kapitale: Ujësjetësi për 15 fshatra dhe qytezën e Dragashit.



## KUBËZIMET NË VITIN 2025

- Kubëzimi i rrugëve dhe ndërtimi i murit mbrojtës në fshatin Mlik;
- Kubëzimi i rrugëve në rrugët e Pirkuqëve, kroi i dive dhe Hani në Llapushnik në fshatin Brezne - Punime shtesë;
- Kubëzimi i rrugëve dhe ndërtimi i kanalizimit në rrugën Jarilice në fshatin Zlipotok;
- Kubëzimi i rrugëve dhe infrastruktura përcjellëse në fshatin Shajne - Projekt dyvjeçar;
- Kubëzimi i rrugëve në regjionin e Opojës - Grandi i performancës;
- Kubëzimi i rrugëve të Brrutit të vogël nga varrezat deri në fushë në fshatin Brrut – Ritenderim;
- Kubëzimi i rrugëve dhe ndërtimi i ujësjellësit në rrugën Kajqovce në fshatin Libevishtë – Ritenderim;
- Kubëzimi i rrugëve dhe ndërtimi i murit mbrojtës në fshatin Zaplluxhe - Projekt dyvjeçar – Ritenderim;
- Kubëzimi i rrugëve, ndërtimi i trotuareve si dhe rregullimi i përroit në fshatin Vraniq;
- Kubëzimi i rrugës në rrugën Ulica në fshatin Zgatar;
- Kubëzimi i rrugëve në fshatin Pllajnik - Projekt dyvjeçar;
- Hapja dhe kubëzimi i rrugës prekoreka në fshatin Krushevë - Projekt dyvjeçar;
- Kubëzimi i rrugëve Gorni Most, Visok Zavor, Ravnishte mahalla dhe sanimi i kanalizimit Tyrbe dhe podselo në fshatin Restelicë - Projekt dyvjeçar;
- Lot 1 - Kubëzimi i rrugëve Bresanë - Punime shtesë;
- Hapja, trasimi dhe kubëzimi i rrugës Kuk-Kosavë - Projekt dyvjeçar;
- Kubëzimi i rrugës Samedin Emimi dhe Shelqja e Drugës në fshatin Kuk-Punime shtesë;
- Kubëzimi i rrugëve te Xhamija, ndërtimi i murit mbrojtës Qollopek dhe kanalizimi rruga Lugu I Pulës në fshatin Zym - Projekt trevjeçar;
- Kubëzimi i rrugëve Peto Mahalla, Shokovci Lika dhe rregullimi i përronit rruga Xhonjet në fshatin Brod - Faza 2;
- Kubëzimi i rrugëve Adem Berisha, Beteja e Buqes dhe Qerza në fshatin Buqe;
- Kubëzimi i rrugëve në fshatin Pllavë - Projekt dyvjeçar.

## ASFALTIMET NË VITIN 2025

- Asfaltimi i rrugëve dhe ndërtimi i parkingut në rrugën Libevisht -Leshtan në fshatin Leshtan;
- Asfaltimi i rrugëve dhe kubëzimi i rrugëve në regjionin e Gorës në Dragash - (Fshatrat Restelicë, Radeshë) Granti i performancës – DEMOS – Ritenderim.

---

## MURET MBROJTËSE NË VITIN 2025

- Ndërtimi i murit mbrojtës dhe kubëzimi i rrugëve në fshatin Gllloboqicë;
- Ndërtimi i murit rreth lumit në fshatin Kuk - Projekt dyvjeçar;
- Ndërtimi i murit mbrojtës te Xhamia në fshatin Brezne.

## NDRIÇIMI PUBLIK NË VITIN 2025

- Ndërtimi i ndriçimit publik në qendër të fshatit Gllloboqicë;
- Ndriçimi publik në qendër të fshatit Brrut;
- Ndriçimi publik në qendër të fshatit Kuklibeg - Projekt dyvjeçar;
- Ndriçimi publik në qendër të fshatit Pllavë - Projekt dyvjeçar;
- Ndërtimi i ndriçimit publik në qendër të fshatit Rrenc - Punime shtesë;
- Mirëmbajtja e ndriçimit publik në territorin e Komunës së Dragashit - Projekt trevjeçar;
- Ndërtimi i ndriçimit publik në qendër të fshatit Gllloboqicë - Faza 2.

## KANALIZIMET FEKALE DHE ATMOSFERIKE NË VITIN 2025

- Ndërtimi i impiantit për ujërat e zeza në rrugën e mullinit në fshatin Brezne;
- Ndërtimi i kanalizimit dhe ujësjellësit në qendër të fshatit Kapre - Projekt dyvjeçar;
- Rehabilitimi i ujësjellësve, kanalizimeve dhe pusetave në tërë territorin e Komunës së Dragashit - Projekt 36 muaj;
- Ndërtimi i kanalizimit dhe kubëzimi në rrugën Brezne-Likeni në fshatin Brezne - Projekt dyvjeçar;
- Renovimi i rrjetit të kanalizimit në fshatin Rapçë.

## TROTUARET NË VITIN 2025

- Ndërtimi i trotuareve Brodosanë-Zaplluxhe si dhe Brrut-Bellobrad - (Granti I Performancës);
- Ndërtimi i trotuarit Dragash - Ura e fshatit Shajne, ndërtimi i trotuarit Dragash - fshati Kukajan - (Granti I Performancës).

---

## INVESTIMET NË ARSIM DHE SHËNDETËSI NË VITIN 2025

- Rehabilitimi i ngrohjes në shkollën “Ulina” Kosavë;
- Ndërtimi i këndit të lojërave, kubëzimi, demolimi i shkollës së vjetër në fshatin Bresanë;
- Renovimi (Adaptimi) i kabinetit të Mjekësisë në SHML “Ruzhdi Berisha” – Dragash;
- Ndërtimi i nyjeve sanitare dhe hapësirës multifunksionale në SHML “Ruzhdi Berisha” – Dragash - Projekt dyvjeçar;
- Renovimi i QMF-së dhe AMF-ve në fshatrat e Gorës - Projekt trevjeçar;
- Renovimi i koridoreve dhe shkallëve në objektin e QKMF-së dhe ljerja e objektit të Hendikosit.

## INVESTIMET NË FUSHËN E SPORTIT NË VITIN 2025

- Ndërtimi i stadiumit në fshatin Restelicë - Projekt dyvjeçar;
- Ndërtimi i stadiumit në fshatin Blaç - Projekt trevjeçar;
- Ndërtimi i stadiumit në fshatin Pllavë - Projekt dyvjeçar;
- Ndërtimi i terreneve sportive Libevishtë - Projekt dyvjeçar;
- Mirëmbajtja dhe riparimi i zhveshtores në stadiumin e Dragashit.

## Subvencionet për projekte kulturore, rinore dhe sportive

Gjatë vitit 2025, Komuna e Dragashit ka mbështetur financiarisht OJQ të ndryshme për organizimin e aktiviteteve të shumta në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit. Shuma e përgjithshme e mbështetjes financiare për këto projekte ka qenë **147 mijë euro**.

<i>Nr.</i>	<i>Emri i OJQ-së</i>	<i>Emri i projektit</i>	<i>Shuma</i>
<b>NË FUSHËN E SPORTIT</b>			
1.	<b>KLUBI I KUAJVE "OPOJA"</b>		<b>7.000€</b>
2.	<b>KLUBI I SHAHUT "SHARRI"</b>		<b>4.000€</b>
3.	<b>SHKOLLA E FUTBOLLIT "FC DRAGASH"</b>		<b>6.000€</b>
4.	<b>SHKOLLA E FUTBOLLIT "AROMA"</b>		<b>4.500€</b>
5.	<b>KLUBI I FUTBOLLIT "OPOJA"</b>		<b>21.500€</b>
6.	<b>KLUB SPORT "SHARRI"</b>		<b>4.500€</b>
7.	<b>KLUBI I SKITARISË "ARXHENA"</b>		<b>2.000€</b>
8.	<b>KLUBI I MOTORRISTËVE "ENDURO SHARRI"</b>		<b>5.500€</b>
9.	<b>KLUBI I ÇIKLIZMIT "OPOJA"</b>		<b>1.500€</b>
10.	<b>KLUBI I BASKETBOLLIT "SHARRI"</b>		<b>1.000€</b>
<b>Gjithsejtë në fushën e sportit:</b>			<b>57.500€</b>
<b>NË FUSHËN E KULTURËS</b>			
1.	<b>NVO"INTER KLUB SPORT" RESTELICË</b>	<b>- DITËT E MËRGATËS</b>	<b>4.500€</b>

2.	<b>SHKA "OPOJA" BUQE</b>	- DITËT E MËRGATËS	<b>6.000€</b>
3.	<b>NVO"EMKACBEND"- RESTELICË</b>	- DITËT E MËRGATËS	<b>4.000€</b>
4.	<b>DFD"BISER" RESTELICË</b>	- DITËT E MËRGATËS	<b>4.000€</b>
5.	<b>OJQ"QENDRA" DRAGASH</b>	- DITËT E MËRGATËS	<b>4.000€</b>
6.	<b>NVO"MILJINA" BROD</b>	- DITËT E MËRGATËS	<b>3.000€</b>
7.	<b>NVO"STARS" RADESHË</b>	- DITËT E MËRGATËS	<b>5.000€</b>
8.	<b>NVO"DEMOKRATSKA OMLADINA GORA" DRAGASH</b>	- DITËT E MËRGATËS	<b>5.000€</b>
9.	<b>SHKA"BRESANA" BRESANË</b>	- Festivali Ballkanik i Folklorit të Valleve " Opoja Vallëzon"	<b>34.000€</b>
10.	<b>SHAKA"BRESANA" BRESANË</b>	- Manifestimet e komunës, ruajtja e folklorit, promovimi i vlerave kulturore dhe pjesëmarrja në festivale brenda e jashtë Kosovës	<b>11.000€</b>
<b>Gjithsejtë në fushën e kulturës:</b>			<b>80.500€</b>
<b>NË FUSHËN E RINISË</b>			
1.	<b>OJQ"AVOKO"</b>	- Mbështetja dhe fuqizimi i organizatave rinore në zhvillimin e aktiviteteve specifike për të rinjtë që ndikon drejtpërsëdrejti në nxitjen e aktiviteteve në fusha të ndryshme	<b>9.000€</b>
<b>Gjithsejtë në fushën e rinisë:</b>			<b>9.000€</b>
<b>SHUMA E PËRGJITHSHME E SUBVENCIONEVE NË FUSHËN E KULTURËS, RINISË E SPORTIT:</b>			<b>147.000€</b>

## PJESËMARRJA E QYTETARËVE NË VENDIMMARRJE

Gjatë periudhës raportuese për vitin 2025, Komuna e Dragashit ka zhvilluar aktivitete të rregullta të konsultimeve publike, përfshirë **takime publike dhe dëgjime buxhetore**, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Në total janë realizuar **dy takimet e rregullta publike** me qytetarë brenda dy gjashtëmujorëve. Gjithashtu, gjatë vitit 2025 janë realizuar edhe **gjashtë dëgjime buxhetore**, tri prej të cilave për Kornizën Afatmesme Buxhetore dhe tri për Draftin e Buxhetit të vitit pasues 2026. Në këto dërgjime Komuna e Dragashit ka synuar pjesëmarrjen sa më të gjerë të qytetarëve, përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe grupeve të ndryshme të interesit, me qëllim të përfshirjes së tyre në proceset vendimmarrëse dhe planifikuese të Komunës.

Lloji i konsultimit	Nr. total i pjesëmarrësve	Gra	Burra
TAKIMET PUBLIKE	75	18	57
DËGJIMET BUXHETORE	82	14	68
<b>Totali:</b>	<b>157</b>	<b>32</b>	<b>125</b>

## QASJA NË DOKUMENTE PUBLIKE

Transparenca dhe llogaridhënia mbeten ndër shtyllat kryesore të qeverisjes së mirë lokale. Në këtë kuadër, Komuna ka trajtuar me prioritet të veçantë zbatimin e legjislacionit në fuqi për qasje në dokumente publike, duke garantuar të drejtën e çdo qytetari për informim të plotë, të saktë dhe në kohë.

Gjatë vitit raportues, administrata komunale ka siguruar trajtimin efikas të kërkesave për qasje në dokumente publike, në përputhje me afatet ligjore dhe standardet e transparencës institucionale. Përmes bashkëpunimit ndërmjet drejtorive komunale dhe Zyrës për Informim, është mundësuar shqyrtimi profesional i çdo kërkesë, duke respektuar njëkohësisht parimet e mbrojtjes së të dhënave personale.

## Të Dhënat Lidhur me Kërkesat për Qasje në Dokumente Publike

Numri i kërkesave të pranuar			
Numri total i kërkesave gjatë vitit 2025	Kërkesat e aprovuara plotësisht	Kërkesat e aprovuara pjesërisht	Kërkesat e refuzuara
6	6	0	0

## Profili i Aplikuesve dhe Dokumentet e Kërkuara

Profili	Numri i kërkesave	Dokumenti	Numri i kërkesave
Mediune	1		
OJQ	2	Shpenzim i parasë publike	2
Individë	2	Dokumente administrative	1
Të tjerë	1	Statistika	1
		Dokumente lidhur me marrëdhënien e punësimit	2

## SEKTORI LIGJOR

**Zyra Ligjore**, në kuadër të ushtrimit të përgjegjësive dhe autorizimeve të saj, si dhe në funksion të zbatimit të ligjeve dhe akteve nënligjore, për periudhën **janar – dhjetor 2025**, është angazhuar në ofrimin e ndihmës juridike, shërbimeve dhe këshillimeve ligjore, si dhe në harmonizimin, plotësimin, ndryshimin dhe hartimin e akteve nënligjore të propozuara nga Kryetari i Komunës, Kuvendi i Komunës dhe Drejtoritë Komunale në Komunën e Dragashit.

Për periudhën **janar – dhjetor 2025**, në këtë sektor është bërë:

- Udhëheqja e procedurave administrative sipas lëndëve përkatëse;
- Ofrimi i këshillave dhe opinioneve ligjore për Kryetarin e Komunës, Kuvendin e Komunës, Drejtoritë Komunale, sektorët dhe njësitë organizative;
- Hartimi dhe harmonizimi i rregulloreve dhe akteve juridike në përputhje me legjislacionin në fuqi, përfshirë vendime, urdhëresa, marrëveshje dhe shkresa përcjellëse për Kryetarin, Kuvendin dhe Drejtorët e Drejtorive;
- Pjesëmarrja në komisionet e ndryshme të formuara nga Kryetari i Komunës për çështje të caktuara;
- Pjesëmarrja në të gjitha seancat e Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve të themeluara nga Kuvendi i Komunës;
- Kryerja e veprimeve në mënyrë të vazhdueshme dhe permanente;
- Arkivimi dhe sistemimi i dokumenteve të Zyrës Ligjore, si dhe përcjellja e vazhdueshme e ligjeve, udhëzimeve administrative dhe rregulloreve të nxjerra nga institucionet qendrore;
- Realizimi i objektivave të planifikuara për gjashtëmujorin e parë të vitit 2025.

#### OBJEKTIVAT E ARRITURA

Zyra Ligjore gjatë vitit 2025 ka dhënë kontribut të rëndësishëm në fushën e këshillimit dhe dhënies së opinioneve ligjore për të gjitha nevojat e administratës komunale, duke përfshirë edhe Kuvendin e Komunës.

Në vijim paraqiten aktet e hartuara nga Sektori Ligjor:

<b>Nr.</b>	<b>Përshkrimi i lëndëve</b>	<b>Numri i lëndëve</b>
1	Vendime për mjete për shërim	318 (165 gra, 153 burra)
2	Vendime për mjete për shërim me kancer gjiri	46 (45 femra , 1 mashkull)
3	Vendime për mjete për shërim fëmijë	20 (8 vajza, 12 djem)
4	Vendime për mjete për dializë	14 ( 4 femra, 10 meshkuj)
5	Vendim për pagesën e qirasë për 2 muaj sipas rekomandimit të QPS-së.	1
6	Vendim për ndihmë momentale për rastin tragjik të familjes F.I.	1
7	Vendime për botim të librit	3
8	Vendime për mjete për OJQ	4
9	Vendim për mjete për familjet e dëshmorëve	3 (3 anëtar)
10	Vendim për mjete për persona me nevoja të veçanta	2 (7 anëtar)
11	Vendim për mjete për stërvitje në K.F. Barça kamp	2
	<b>Total nr. i vendimeve</b>	<b>414</b>

<b>Nr.</b>	<b>Mjetet e lejuara nga pozicionet tjera</b>	<b>Numri i lëndëve</b>
1	Vendim për mjete për maturanet	1
2	Vendim për udhëtime zyrtare	22
3	Vendime për dreka zyrtare	37
4	Vendim për pagesën e energjisë elektrike për ndriçim publik	12
5	Vendim për sigurimin e mjeteve për kartela për mbushje telefonike	11
6	Vendim për lejimin e mjeteve për Informim	17
7	Vendim për lejimin e mjeteve derivate	8
8	Vendim për lejimin e mjeteve – Vizitë studimore për asambleistët	1
9	Vendim për lejimin e mjeteve – Vizitë studimore për administratën	1
10	Vendim për pagesën e bursës për student	1 (104 përfitues)
11	Vendime të ndryshme	191
<b>Totali i vendimeve</b>		<b>302</b>

<b>Nr.</b>	<b>Lëndët e ndryshme</b>	<b>Numri i lëndëve</b>
1	Autorizime	3
2	Marrëveshje bashkëpunimi dhe mirëkuptimi për bashkëfinancim	18
3	Memorandume bashkëpunimi dhe mirëkuptimi	7
4	Aneks Memorandumi me Agjencionin Kadastral	1
5	Kontrata	26
6	Kontrata për punë	30
7	Aneks kontratë për shërbime postare	1
8	Raporte të ndryshme	6
9	Njoftime	4
10	Njoftim për diskutim publik	2
11	Njoftim për takime publike	2
12	Formular të ndryshëm	3
13	Kalendar i dëgjimeve buxhetore	1
14	Plane të Punës	7
15	Raporte të Punës	7
16	Raporte 6 mujore të auditimit	2
17	Raport vjetor i auditimit	1
18	Raporti i progresit fizik dhe financiar	3
19	Urdhër për pagesë	1
20	Urdhëresa	1
21	Lista e të dhënave të dëshmorëve dhe viktimave të luftës	1
22	Letër konfirmimi për mbështetje	1
23	Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve	1
24	Formë e autorizimeve për listën e pagave	1

25	Shtojcë për programin për bashkëfinancim me donator	1
26	Formular për aplikim për trajnim	3
27	Formular i raportimit vjetor financiar 2024	2
28	Shkresa njoftuese	3
29	Planifikimi buxhetor për vitin 2025	2
30	Debate Publike	2
31	Dëgjime Publike	2
32	Kërkesë e Presidentes	1
	<b>Totali i lëndëve</b>	<b>146</b>

<b>Nr.</b>	<b>Kërkesat e Kryetarit të Komunës drejtuar Ministrive dhe Organizatave tjera</b>	<b>Numri i lëndëve</b>
1	Kërkesë për shpronësim të pasurisë së paluajtshme të cilën e menaxhon AKP-ja për MMPHI	5
2	Kërkesë për shpronësim të pasurisë së paluajtshme të cilën e menaxhon AKP-ja për MAPL	5
3	Kërkesë për trasimin e rrugës Pllajnik-livadhët e Radeshës për KFOR-in Turk	1
4	Kërkesë për inicim të procedurës për binjakëzim për Kuvendin e Komunës	2
5	Kërkesë për pajisje me leje parkimi "VIP" për veturat zyrtare të komunës së Dragashit, për MPB-AP	1
6	Kërkesë për mbështetje në angazhimin e 20 praktikantëve në QKMF, për agjencinë e punësimit	1
7	Kërkesë për ndërtimin e këndit të lojërave për fëmijë në ShFMU "Uina", për KFOR-in Turk	1
8	Kërkesë për ndërtimin e një fushe sportive në fsh.Lubovishtë, për KFOR-in Turk	1
9	Kërkesë për trasimin e rrugës Radeshë-bjeshka e Radeshës, për KFOR-in Turk	1
10	Kërkesë për hapjen trasimin e rrugës Rrenc-Xërxe, për KFOR-in Turk	1
11	Kërkesë për kompletimin e transformatorit të rrymës në bjeshkën e f.sh.Zaplluxhe për KEDS	1
12	Ankesë lidhur me vlerësimin e gabuar të treguesve të performancës Komunale të komunës së Dragashit për komisionin e ankesave të MAPL-së Prishtinë	1
13	Kërkesë për hapjen trasimin dhe zgjerimin e rrugës këmbësore, për KFOR-in Turk	1
14	Kërkesë për furnizimin me zengjin të rrotave traktorët e komunës, për KFOR-in Turk	1

15	Kërkesë për zgjerimin e rrugës ekzistues në fsh.Radeshë, për KFOR-in Turk	1
16	Ankesë e kryetarit të Komunës për Hidroregjionin Jugor Sh.A. dega në Dragash	1
17	Kërkesë për futjen e rrugës Krushevë-Shishtavec nën menaxhimin e drejtorisë Rajonale të Mirëmbajtjes së Rrugëve-Prizren, për MMPHI departamenti i Infrastrukturës Rrugore	1
18	Kërkesë për ndërtimin e trasesë së rrugës Qollopek-Kapre, për KFOR-in Turk	1
19	Kërkesë për furnizim me pajisje të kuzhinës për restaurant “Tre Vëllezërit” nga fsh.Kuk, për KFOR-in Turk	1
20	Kërkesë për vazhdimin e datës për përfundimin e punimeve, për MAPL-në Prishtinë	1
21	Kërkesë për rehabilitimin e rrugës malore në fsh.Plavë, për KFOR-in Turk	1
22	Kërkesë për furnizim me pajisje për kabinet të informatikës në ShML Ruzhdi Berisha në Dragash, për KFOR-in Turk	1
	<b>Total Kërkesa</b>	<b>31</b>

Nr.	Kërkesat e ndryshme	Numri i lëndëve
1	Kërkesa MAPL-së dhe Drejtorisë së Thesarit	91
2	Konfirmime Drejtoria e Thesarit – Ministria e Financave	2
3	Formular për barazim mujor Ministria e Financave	6
4	Njoftime Ministria e Financave	2
5	Pyetësor i vlerësimit Ministria e Financave	1
6	Kërkesa për rekrutim – punësim	31
	<b>Total Kërkesa</b>	<b>133</b>

Nr.	Vendimet e Zyrës së Prokurimit	Numri i lëndëve
1	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës	38
2	Vendim për caktimin e ekipit për menaxhimin e kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës	42
3	Vendim për themelimin e komisionit për pranimin teknik të punimeve	98
4	Vendim për shpalljen e tenderëve	80
5	Vendim për formimin e komisionit për zhvillimin e procedurave për punime shtesë	22
6	Vendim për caktimin e zyrtarëve autorizues	10
7	Vendim për shpallje të aktiviteteve të prokurimit	1
	<b>Total lëndët e prokurimit</b>	<b>291</b>

---

## PËRMBYLLJE

Viti raportues është karakterizuar nga një angazhim i vazhdueshëm në realizimin e objektivave strategjike të Komunës, në përmirësimin e shërbimeve për qytetarët dhe në forcimin e qeverisjes së mirë. Përmes planifikimit të kujdesshëm, menaxhimit të përgjegjshëm financiar dhe koordinimit ndërinstytucional, është arritur progres i dukshëm në disa fusha kyçe të zhvillimit lokal. Përkushtimi institucional mbetet i orientuar drejt rritjes së efikasitetit, transparencës dhe llogaridhënies, si dhe drejt krijimit të kushteve më të mira për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik e social.

Ky raport shërben si bazë për planifikimin e mëtejshëm dhe për avancimin e prioritetëve zhvillimorë të Komunës në vitin pasues.

### **Prioritetet tona kryesore për Dragashin vazhdojnë të jenë:**

- Administratë efikase, e përgjithshme dhe me shërbime moderne;
- Organizim më i mirë i punës dhe efikasitet i plotë i administratës së Komunës;
- Realizim i suksesshëm i projekteve dhe i buxhetit;
- Realizim i planit të të hyrave të Komunës;
- Rritja e përkrahjes për bujqësinë dhe për fermerët;
- Zhvillimi i turizmit dhe ndërtimi i infrastrukturës përcjellëse;
- Nxitje të investimeve dhe projekteve në turizëm;
- Trotuare dhe shtigje të ecjes për këmbësorë dhe biçiklistë;
- Investime për ndriçim publik;
- Rritje e cilësisë dhe investime në arsim;
- Investime në nyje sanitare dhe meremetim të shkollave;
- Bursa për studentë;
- Hartimi i PZhK-së dhe Hartës Zonale;
- Terrene të reja sportive dhe përkrahje e sportit, aktivitete të planifikuara me të rinjtë;
- Krijimi i kushteve të përshtatshme për investime të drejtpërdrejta për të mirën e qytetareve përmes krijimit të vendeve të përhershme të punës si dhe zhvillimit ekonomik;
- Bashkëpunimi me komunitetin fetar, shoqëritë civile OJQ ndërkombëtare, vendore dhe partner të tjerë.



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA- REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA DRAGASH/OPŠTINA DRAGASH/ MUNICIPALITY OF DRAGASH  
Drejtoria e Administratës – Direktorat za Administraciju - Directorat of Administration



Data/Date/ Datum;	25.02.2026
Për / To/Za :	Zyrën e Kryetarit
Nga /From/ Od	Drejtoria e Administratës
Lënda/Subject/Tema:	Raporti i punës për vitin 2025

## RAPORTI VJETOR I PUNËS

01.01.2025 – 31.12.2025

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
Komuna e Dragashit  
Opština Dragaš

OL Nr. Br. 052/01-3469/26  
25.02.2026  
Dragash - Dragaš

Shkurt, 2026



Raporti vjetor i hartuar nga Drejtoria për Administratë të Përgjithshme ka për qëllim që të pasqyrojë aktivitetet dhe punën që është zhvilluar gjatë vitit 2025 në sektorët që i përkasin kësaj drejtorie si dhe informimin e drejtë të qytetarëve, institucioneve komunale, shoqërisë civile dhe të gjitha palëve që janë të interesuara për punën e kryer gjatë këtij viti.

Duke marrë parasyshë faktin se Drejtoria e Administratës është ura lidhëse e shërbimeve të institucioneve lokale me qytetarët dhe institucionet qendrore, shërbimi i Administratës Komunale ka qenë i përkushtuar në ofrimin e shërbimeve sa më cilësore.

Kjo drejtori ka bërë ushtrimin dhe zbatimin e shërbimeve të përgjithshme administrative për organet administrative dhe organet tjera komunale dhe ofrimin e shërbimeve për qytetarët e Komunës së Dragashit konform ligjeve, udhëzimeve administrative dhe rregulloreve në fuqi, gjatë vitit 2025. Shërbimet të cilat komuna u ofron qytetarëve të saj bazohen në nevojat dhe kërkesat e qytetarëve duke qenë në harmoni të plotë me ligjet dhe udhëzimet administrative të Republikës së Kosovës.

Drejtoria për Administratë të Përgjithshme punën e saj e bazon brenda kornizave ligjore të cilat janë në fuqi si:

- Ligji për Vetëqeverisjen Lokale;
- Ligji për Zyrtarët Publik;
- Ligjin mbi Librat Amzë;
- Statutin e Komunës;
- Rregulloret komunale;
- Urdhëresat dhe Udhëzimet Administrative.



Drejtoria për Administratë të përgjithshme është kujdesur që gjatë vitit 2025 të krijojë kushte më të përshtatshme të punës për zyrtarët, në mënyrë që shërbimet të jenë në nivel të kënaqur për qytetarët e Komunës së Dragashit.

Nga buxheti i Drejtorisë për Administratë të përgjithshme, ashtu siç janë planifikuar mjetet, kemi arritur që t'i realizojmë qëllimet duke mbuluar:

- Pagat për stafin që i përkasin Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme;
- Shërbimi i telefonisë mobile;
- Shërbimet postare,;
- Shërbimet e shtypjes (printim dhe skanim);
- Shërbimet e ujësjellësit;
- Shërbimi i mirëmbajtjes së veturave zyrtare në kuadër të DAP;
- Furnizimi me inventar për nevojat e Komunës së Dragashit;
- Furnizim me material hargjues-higjienik për nevojat e Komunës së Dragashit;
- Furnizim me derivate për nevojat e automjeteve zyrtare;
- Përmbushja e nevojave të tjera rreth objektit të Komunës së Dragashit;
- Bashkëpunim me drejtoritë e tjera për realizimin e projekteve.

Të gjitha shpenzimet e Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme janë të paraqitura edhe në raportet financiare.

Drejtoria e Administratës së Përgjithshme në aspektin organizativ ndahet në disa sektorë që do të paraqiten si në vijim:

- I. Sektori i Gjendjes Civile (Ofiqaria);**
- II. Zyra për Shërbime të Qytetarëve dhe Arkivi;**
- III. Zyra e Prokurimit;**
- IV. Shërbimet Teknike;**
- V. Njësia për IT.**

**Vendosja e te dhënave sipas raporteve nga Sektorët:**

**Bazuar në raportet e dërguara nga udhëheqësit e sektorëve në Drejtorinë e Administratës, raporti i punës për periudhën 01.01.2025 – 31.12.2025 është si vijon:**



## I. Sektori i Gjendjes Civile (Ofiqaria)

Shërbimi i Gjendjes Civile në Komunën e Dragashit gjatë periudhës Janar-Dhjetor të vitit 2025 ka arritur që të jetë shumë efikas dhe t'i shërbejë të gjithë qytetarët në kohë optimale. Gjatë kësaj periudhe, ky shërbim, në kuadër të kompetencave të tij kryen një sërë aktivitetesh që do t'i paraqesim në vazhdim të këtij raporti.

Me punën e zyrtarëve të Gjendjes Civile arrihet që të lëshohen një numër i konsiderueshëm i dokumenteve nga ky sektor, ku varion nga 30,000 deri në 35,000 sosh brenda një viti. Kjo tregon që shërbimi për marrjen e një dokumenti të nevojshëm për qytetarët është shumë i shpejtë, efikas, i qëndrueshëm dhe i përgjegjshëm me kapacitetet aktuale që kemi.

Ashtu siç edhe e thekson Statuti i Komunës sonë, Shërbimi i Gjendjes Civile (Ofiqaria) është i organizuar në pesë lokacione të cilat gjenden si në vijim:

- Dragash;
- Bresanë;
- Llapushnik;
- Krushevë;
- Brod.

Këto pesë lokacione janë të vendosura në këtë mënyrë me qëllim që qytetarët t'i kenë sa më afër Shërbimet e Gjendjes Civile ku mbulohet i gjithë territori i Komunës sonë.

Gjatë këtij viti kemi pasur rritje të kërkesave për shërbimet që ofron Zyra e Gjendjes Civile dhe me ardhjen e bashkëatdhetarëve tanë të cilët jetojnë jashtë Republikës së Kosovës, vlen të theksohet se edhe gjatë ditëve të punës (e hënë - e premte) është punuar me orar të zgjatur nga ora 15:30 deri në ora 17:00.

Drejtoria e Administratës është kujdesur që të sigurojë kushte të punës për të gjithë zyrtarët, duke vazhduar pajisjen me mjete moderne të IT-së, në mënyrë që të rritet efienca e shërbimeve.

Më poshtë do ta paraqesim në mënyrë tabelare punën e Shërbimit të Gjendjes Civile, ku në detaje janë të paraqitura statistikat, varësisht nga lloji i certifikatës, regjistrimet në regjistrat themeltarë dhe regjistrimet në regjistrat e veçantë nga bota e jashtme.



❖ Për periudhën Janar –Dhjetor të vitit 2025 janë lëshuar këto dokumente të Gjendjes Civile:

Nr.	Lloji i certifikatës	Brenda vendit	Jashtë vendit	Totali
1.	Certifikatë lindjeje	351	6074	6425
2.	Ekstrakt lindjeje	12271	1052	13323
3.	Certifikatë martese	2229	1851	4080
4.	Deklaratë e bashkësisë familjare	1121	268	1389
5.	Certifikate vendbanimi	1994	490	2484
6.	Certifikatë e shtetësisë	49	146	195
7.	Certifikatë e gjendjes martesore	393	240	633
8.	Vërtetim nga arkiva	230	160	390
9.	Certifikatë vdekjeje	1842	323	2165
<b>Totali</b>				<b>31084</b>

Dëshmi vdekjeje (Aktvdekje).....220

❖ Regjistrimet në regjistrat themeltarë:

Nr.	Lloji	Sasia
1.	Aktet e Lindjes	0
2.	Aktet e Martesës	207
3.	Akte të Vdekjes	37

❖ Regjistrimet ne regjistrat e veçantë nga bota e jashtme:

Nr.	Lloji	Sasia
1.	Aktet e Lindjes	205
2.	Aktet e Martesës	86
3.	Akte të Vdekjes	109

- Për Kërkesa për lirim nga shtetësia e RKS kanë aplikuar 25 persona;

- Për Kërkesa për fitimin e shtetësisë së RKS-së kanë aplikuar 167 persona;

- Në bazë të Nenit 31 dhe Nenit 32 të **LIGJI NR. 04/L-215 PËR SHTETËSINË E KOSOVËS** janë regjistruar 12 persona.

- Shkurorëzime janë regjistruar 35.



Të hyrat e inkasuara nga Shërbimi i Gjendjes Civile në periudhën **01.01.2025** deri **31.12.2025** dhe të dorëzuara tek Zyrtari i Pasurisë së Komunës kapin vlerën prej **32,363.00€**.

Sa i përket zbatimit të Platformës Elektronike eKosova, gjatë vitit 2025 kjo platformë është përdorur mjaftueshem, ku në total kemi **10316 dokumente të lëshuara** dhe të ndara si vijon:

NR.	LLOJI I DOKUMENTIT	SASIA
1.	Certifikata e lindjes	4782
2.	Ekstrakt nga RQGJ	3679
3.	Certifikata e martesës	1640
4.	Certifikata e vdekjes	215
TOTAL:		<b>10316</b>

Po ashtu, nga data 01.10.2024 deri me datën 31.12.2025, gjatë procesit të ndërlidhjes me adresa zyrtare janë regjistruar 27.389 qytetarë të Komunës së Dragashit.

Po ashtu, me qëllim mirëmbajtjen e stokut të formularëve është bërë edhe furnizimi me formularë të certifikatave nëpër zyrat e Gjendjes Civile në total prej 10.400 sosh.

Të gjitha këto statistika të pasqyruara në këtë Raport, si dhe tabelat e detajizuara, janë përcjellur në baza të rregullta në Entin e Statistikave të Kosovës.

## II. Zyra për Shërbime të Qytetarëve dhe Arkivi

Zyra për Shërbim të Qytetarëve u shërben qytetarëve për t'u informuar me procedurat e nevojshme për kryerjen e punëve administrative në harmoni me dispozitat ligjore për kryerjen e shërbimeve të ndryshme nga organet e administratës komunale. Zhvillimi i procedurave bëhet si në vijim: fillimisht paraqitet kërkesa, protokollohet, skanohet, ruhet në sistemin e INTRANET-it dhe më pas shpërndahet me anë të librave të brendshëm dhe elektronikë deri tek drejtoritë përkatëse nga ana e personit të autorizuar për kryerjen e këtij shërbimi. Protokollin për këtë procedurë administrative mbahet në mënyrë elektronike si dhe me shkrim, njëherit të gjitha kërkesat, dokumentet dhe shkresat të cilat janë të protokolluara, skanohen dhe më pas përcillen në ministri dhe në drejtori përkatëse me anë të sistemit të INTRANET-it. Kështu, në çdo moment mund të përcjellim në këtë sistem azhurimet e shërbimeve përbrenda Komunës. Në periudhën kohore 01.01.2025 – 31.12.2025, në këtë zyrë janë regjistruar gjithsej **34822 lëndë**.

Në këtë zyre gjithashtu kryhen edhe pagesat e shërbimeve komunale sipas Rregullores mbi Taksat Komunale për shërbime të caktuara. Gjatë vitit 2025 janë inkasuar gjithsej **10,372.00 €**.



### III. Zyra e Prokurimit

Zyra e Prokurimit funksionon në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës dhe akteve të tjera që janë nxjerrë nga ky Ligj.

Kjo zyrë, edhe pse me mungesë stafi konform nevojave, gjatë vitit 2025 ka qenë mjaftë efikase duke arritur që të kryejë të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë me një dinamikë të jashtëzakonshme duke realizuar kështu me sukses buxhetin e planifikuar për këtë vit.

Të gjitha projektet, duke përfshirë projektet e investimeve kapitale, projektet për blerjen e mallrave dhe shërbimeve si dhe për nevoja të tjera të të gjitha sektorëve të Komunës së Dragashit kemi arritur t'i realizojmë me sukses dhe në kohë. Në vazhdim do të paraqesim punët që ka kryer kjo zyrë duke pasur bashkëpunim të ngushtë me të gjitha drejtoritë përkatëse, në mënyrë që të realizohen të gjitha objektivat e parapara për këtë vit.

Gjatë vitit 2025 kjo zyrë ka zhvilluar gjithsej **133 aktivitete prokurimi** me një vlerë totale të parashikuar të kontratave prej **6,033,664.99€** dhe si rezultat, shuma e kontratave të nënshkruara të projekteve të investimeve kapitale, mallrave dhe shërbimeve arrin shumën prej **4,483,115.00€**, shumë kjo e cila iu është bërë në formë pagese Operatorëve Ekonomikë (OE) të ndryshëm.

Kjo vlerë e paraqitur në këtë raport është realizuar me një numër të madh operatorësh ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë përmes ofertimit në procedurat e iniciuara nga ana e Komunës së Dragashit.

Me qëllim ngritjen e transparencës dhe llogaridhënies, të gjitha kontratat e nënshkruara me Operatorët Ekonomikë janë publikuar edhe në webfaqen e Komunës së Dragashit, në mënyrë që të gjithë qytetarët apo grupet e ndryshme të interesuara për aktivitetin e Zyrës së Prokurimit të kenë qasje dhe të përcjellin nga afër punën e kësaj zyreje dhe qeverisjes lokale në përgjithësi.



#### IV. Shërbimet Teknike

Në kuadër të këtij shërbimi janë të përfshira këto njësi:

1. **Autoparku i Komunës;**
2. **Rojet e objekteve Komunale;**
3. **Shërbimi i pastrimit të objekteve Komunale;**
4. **Depoja e Komunës.**

**Autoparku:** Ky shërbim gjatë vitit 2025 ka qenë i organizuar me tre punonjës të stafit teknik, të cilët janë vozitës të veturave të Administratës. Kështu që, gjatë këtij viti kanë funksionuar veturat zyrtare të komunës dhe janë shfrytëzuar nga zyrtarët komunalë të cilët, për nevoja të komunës, kanë udhëtuar brenda komunës, brenda dhe jashtë vendit, varësisht nga ftesat apo punët zyrtare që janë paraqitur nga zyrtarët e drejtorive të ndryshme.

Zyrtarët e autoparkut të komunës janë kujdesur për evitimin e problemeve të ndryshme të veturave zyrtare të komunës, ku janë angazhuar në përcjelljen e afateve të servisimit të rregullt të tyre, sigurimin dhe regjistrimin e të gjitha automjeteve zyrtare duke respektuar afatet kohore, në mënyrë që automjetet të jenë sa më funksionale dhe në gjendje gatishmërie për t'iu përgjigjur nevojave dhe kërkesave të drejtorive të ndryshme brenda komunës dhe jashtë saj.

**Sigurimi i Objekteve Komunale:** Ky shërbim kujdeset për sigurinë e objekteve komunale gjatë natës. Shërbimi është i organizuar me tre puntorë të cilët janë përgjegjës për sigurinë nga rreziqet e ndryshme që mund të paraqiten në objektin e Komunës së Dragashit dhe objektin e ZGJC- Dragash. Gjatë këtij viti nuk kemi pasur kurrfarë vështirësish rreth mirëmbajtjes dhe ruajtjes së objekteve komunale.

**Pastruesit e objektit:** Ky shërbim është përgjegjës për mirëmbajtjen dhe pastrimin e objektit të komunës, duke përfshirë të gjitha zyret dhe hapësirat që janë brenda objektit të Komunës dhe të gjitha hapësirat që gjenden në objektin e ZGJC - Dragash. Shërbimi i Pastrimit funksionon aktualisht me tre puntëorë të cilët furnizohen në bazë javore me material higjienik në deponë e komunës, duke siguruar ambiente pune të pastërta për zyrtarët komunalë dhe ambiente shërbimi sa më të pastërta ndaj qytetarëve.

**Depoja e Komunës:** Shërbimi në deponë e Komunës është i organizuar me një zyrtar të deposë - depoist. Ky shërbim është përgjegjës për pranimin e mallrave shpenzues, menaxhimin e tyre dhe shpërndarjen sipas kërkesave të personelit të Komunës së Dragashit.

Ky shërbim gjatë vitit 2025 ka qenë shumë efikas, duke arritur të plotësojë kërkesat dhe nevojat për furnizim me material shpenzues (zyrtar dhe higjienik) për të gjithë personelin e Komunës, institucionet arsimore dhe Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF - Dragash).



## V. Njësia e Teknologjisë Informative

Njësia për Teknologji Informative është zyrë shumë dinamike dhe konsiderohet si kyçe në punët administrativo-teknike. Kjo zyrë e ka këtë rëndësi për shkak të vizionit dhe realizimit të përditshëm të një qeverisjeje elektronike, duke u kujdesur që planet të realizohen në vepra me përdorim të teknologjisë moderne softverike dhe hardverike.

Kjo zyrë gjatë kësaj periudhe ka zhvilluar në baza ditore aktivitetet si në vijim:

- Intervenime rutinore nëpër kompjuterë të punëtorëve të administratës komunale të cilat kanë pasur nevojë për ruajtjen e shënimeve, formatizimin e tyre, intervenime softverike, etj;
- Mirëmbajtjen e sistemit të INTRANET-it;
- Furnizimi dhe konfigurimi i skanerëve në zyren e pritjes;
- Mirëmbajtja e sistemit elektronik të arkivimit;
- Mirëmbajtja e sistemit të e-Pasuria;
- Kontrollimi dhe mirëmbajtja e përditshme e serverëve komunalë;
- Puna e përditshme në webfaqen e Komunës;
- Mirëmbajtja e llogarive të emailit zyrtar për tërë zyrtarët komunalë;
- Hartimi i Planit detal për mbulimin me pamje audio-vizuele (kamera) të objektit të Komunës dhe objekteve përcjellëse;
- Shtirirja e rrjetit qeveritar edhe në objektin e Shtëpisë së Kulturës në Dragash;
- Krijimin e shfrytëzuesve të ndryshëm në sistemin e INTRANETI-it dhe në domenin qeveritar;
- Punë të ndryshme sipas kërkesave në fushën e teknologjisë informative;
- Takime të ndryshme me ftesë nga Ministria dhe Kolegjiumi i IT-ve në kuadër të AKK-së;
- Asistenca në mbarëvajtjen e mbledhjeve të Asamblesë Komunale, lidhja direkte në kanalim zyrtar në Youtube dhe plasimi i xhirimeve në webfaqen e komunës;
- Intervenime në terren dhe Zyrat e Gjendjes Civile.



Veton Halili  
Drejtor i Drejtorisë së Administratës



Republika e Kosovës – Republika Kosova- Republic of Kosovo  
Komuna e Dragashit – Opština Dragaš- Municipality of Dragas  
Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim Ekonomik  
Direktorijati za Ekonomiju, Finansije i Privredni Razvoj



Datë/a-Datum:	23/02/2026
Referencë	
Për-Za:	Kryetarin Bexhet Xheladini dhe për Kuvendin e Komunës së Dragashit
Përgatitur nga:	Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim
Përmes-Preko :	E-mail dhe Arkivit
Nga-Od:	Qamil Kolloni, drejtor i Drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim
Tema	Raporti i punës për vitin 2025 i Drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
Komuna e Dragashit  
Opština Dragaš

02 Nr. Br. 334/06-3360/26  
24.02.2026  
Dragash - Dragaš

## RAPORTI PUNËS PËR VITIN 2025

nga

**Qamil Kolloni – Drejtor i Drejtorisë**

## **1) Sektori Punuese për Buxhet dhe financa**

Drejtoria për Ekonomi Financa dhe Zhvillim, bazuar në dispozitat e nenit 60 dhe 61 të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, si dhe Qarkoreve Buxhetore 2025/1,2, ka marrë pjesë në përgatitjen e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve dhe Projekt-buxhetin për vitin 2025-2027, për periudhën në fjalë, duke i respektuar afatet dhe procedurat e aprovimit të buxhetit.

Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim ka përgatitur Planin e Veprimit për rekomandimet e auditorit për Pasqyrat Financiare 2024 dhe raportet e progresit për zbatimin e rekomandimeve për raportin e auditimit për vitin 2025.

Sektori për Buxhet dhe Financa raporton përmes përgatitjes së raporteve periodike buxhetore dhe financiare (mujore, tremujore dhe vjetore), duke paraqitur realizimin e të hyrave dhe shpenzimeve, krahasimin me planifikimin buxhetor, analizën e devijimeve, si dhe duke i dorëzuar këto raporte tek Drejtoria përkatëse, Kryetari i Komunës dhe organet mbikëqyrëse në përputhje me legjislacionin në fuqi si asambleja komunale etj. Si dhe në vazhdimësi kryen të gjitha pagesat dhe transaksionet për investimet kapitale, mallra dhe shërbime, si dhe përcakton procedurat për ekzekutimin e pagesave.

## **2) Sektori Për Zhvillim Ekonomik**

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik ka vazhduar të përmbushë detyrat e saj në promovimin dhe zhvillimin e sektorëve ekonomikë të komunës, duke organizuar dhe marrë pjesë në aktivitete të ndryshme me qëllim të fuqizimit të bizneseve lokale, turizmit dhe bujqësisë. Ky raport përmbledh aktivitetet kryesore të realizuara gjatë periudhës raportuese.

1. Mbajtja e Panairit të Turizmit dhe Sportit
2. Pjesëmarrja në Panairin "Agrokos"

Komuna e Dragashit mori pjesë aktive në panairin "Agrokos", i cili kishte për qëllim promovimin e produkteve vendore bujqësore dhe përkrahjen e fermerëve dhe prodhuesve vendorë.

3. Organizimi i Panairit "Expo Sharri", ky panair u organizua në bashkëpunim me Shoqatën e Afaristëve të Komunës së Dragashit, me fokus në promovimin e produkteve dhe shërbimeve lokale të rajonit të Sharrit.
4. Takimi me Bizneset Lokale për Formimin e Këshillit Lokal të Bizneseve
5. Aplikimi në programin e BE për projekte ndërkufitare IPA për vitin 2025.

Gjithashtu drejtoria për Zhvillim Ekonomik ka filluar se punuari strategjinë për zhvillim e ekonomik lokal ku janë të përfshira të gjitha pikat kyçe që ndikojnë në rritjen e zhvillimit ekonomik në komunën e Dragashit.

#### 4) Sektori - për Regjistrimin e Bizneseve dhe menaxhimin e qirave të pronave komunale

Sektori – përgjegjës për Regjistrimin e Bizneseve dhe menaxhimin e qirave të pronave komunale është përgjegjës për ofrimin e shërbimeve administrative ndaj bizneseve dhe për administrimin e pronave komunale të dhëna në shfrytëzim. Ky sektor siguron zbatimin e procedurave ligjore për regjistrimin, ndryshimin dhe çregjistrimin e bizneseve, si dhe menaxhon procesin e kontraktimit, evidentimit dhe monitorimit të pagesave të qirave për pronat komunale. Përmes këtij funksioni, kontribuon në përmirësimin e klimës së të bërit biznes dhe në rritjen e të hyrave komunale.

Ne komunën e Dragashit operojnë gjithsej 1797 biznese në total e që për detaje mund të përcjellni tabelën në vazhdim:

Lloji i bizneseve	Aktive	Pasive	Te Shuara	Total
B individuale	795	503	468	1797
Shpk	115	13	8	136
Ortakri	5	5	3	13
Koperativa	0	6		6
Ndërmarrje shoqerore	0	1		1

#### 5) Sektori i keshit, gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2025, paraqes raportin e hyrjeve dhe daljeve për këtë vit.

Në arkën kryesore kam pranuar nga inkasantët shumën prej **43,271.00 euro**. Të njëjtat mjete, brenda ditës, janë deponuar në bankë, të ndara sipas kodit përkatës në bazë të UNIREF-it për çdo pagesë veç e veç. Për të gjitha këto transaksione është bërë raportimi përkatës dhe barazimi me zyrtarin e të hyrave.

Në të njëjtën periudhë kemi tërhequr shumën prej **5,500.00 euro** për pagesën e faturave të imta deri në 100.00 euro. Të gjitha pagesat janë realizuar me kohë dhe janë mbyllur në fund të vitit.

**Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim** përbën një nga drejtoritë kryesore të administratës komunale, me rol thelbësor në menaxhimin e burimeve financiare dhe në orientimin e zhvillimit ekonomik të komunës. Kjo drejtori është përgjegjëse për planifikimin dhe zbatimin e politikave buxhetore, garantimin e disiplinës financiare, rritjen e të hyrave komunale, si dhe krijimin e kushteve të favorshme për zhvillim ekonomik lokal dhe mbështetje të sektorit privat.

Përmes koordinimit të brendshëm dhe bashkëpunimit me institucionet qendrore, kjo drejtori siguron zbatimin e legjislacionit në fuqi në fushën e financave publike, menaxhimin transparent të mjeteve buxhetore dhe administrimin efikas të pasurisë komunale. Në funksion të realizimit të këtyre përgjegjësive dhe objektivave strategjike, Drejtoria është e organizuar në njësi punuese (sektorë) të specializuara, të cilat mbulojnë fusha të veçanta të veprimtarisë, siç paraqiten në vijim.

**Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim është e organizuar në këta sektorë punues:**

Nr.	Njësitë Punuese (Sektorët)	Veprimtaria
1	Buxhet dhe financa	Përgatitja e buxhetit sipas Qarkores Buxhetore të MEF, raportet financiare - transferet
2	Zhvillimi Ekonomik	Hartimi dhe zbatimi i politikave dhe projekteve që nxisin investimet, punësimin, mbështetjen e bizneseve dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik lokal.
3	Zyra e Tatimit në Pronë	Vlerësimi, faturimi, inkasimi i tatimit në pronë.
4	Zyra për Regjistrimin e Bizneseve	Regjistrimi dhe mbështetjen e bizneseve, si dhe me administrimin dhe mbajtjen e evidencave për pagesat e qirave të pronave komunale.
5	Spektori e Thesarit, Keshi	Menaxhimi e mjeteve financiare të komunës, përfshirë ekzekutimin e pagesave, arkëtimin e të hyrave, menaxhimin e llogarive bankare dhe raportimin financiar në përputhje me legjislacionin në fuqi.
6	Zyra e regjistrimit të pasurive komunale	Përditësimi i regjistrave dhe procedurave lidhur me pasurinë e komunës.

### 3) Sektori e Tatimit në Pronë

Sektori i Tatimit në Pronë është njësi organizative në kuadër të Drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim, përgjegjëse për administrimin e tatimit në pronë në territorin e komunës. Ky sektor siguron zbatimin e legjislacionit përkatës përmes vlerësimit të pronave të paluajtshme, përditësimit të te dhënave, lëshimit të faturave dhe inkasimit të tatimit. Përmes menaxhimit të saktë dhe transparent të këtij procesi, sektori kontribuon drejtpërdrejt në rritjen e të hyrave vetanake komunale dhe në forcimin e stabilitetit financiar të komunës.

Aktivitetet e këtij sektori i ndiqni si ne vijim:

Në vitin 2025 janë printuar dhe dorëzuar gjithsej 7.639 fatura tatimore në pronë. Shpërndarje 4,268 , ose 55,87%. Pjesa tjetër nuk u shpërnda për shkak të mungesës së tatimpaguesve (jashtë vendit).

1. Numri i pronave(objekteve) ne komune.....	11,618
2. Numri I pronave (objekteve) te ri-anketuara (ri-vlersimet).....	776
3. Objektet te reja te regjistruara.....	193
Ngarkesa për vitin 2025 për objekte.....	165.781.36 €
Ngarkesa për vitin 2025 për parcella.....	283.957.93€ €
TOTAL Ngarkesa per 2025:.....	449.739.29 €
Pagesa e tatimit për vitin 2025 për objekte (pa borxhe dhe penalti).....	49.131.66 €
Pagesa e tatimit për vitin 2025 për parcella (pa borxhe dhe penalti).....	66.706.97 €
TOTAL Pagesa per viti 2025 :.....	115.838.63 €

E shprehur në përqindje është 25.75%

- 1) Totali i tatimit të arkëtuar mbi pasurinë e paluajtshme në vitin 2025, me interes dhe dënim është: 115.838.63 €, ose shprehur me 25.76%. (free balance, SIMFK).
- 2) Totali i tatimit te arkëtuar mbi pasurinë e pa luajtshme ne vitin 2025 me interes dhe dënim është : 270.000 € ... 60% free Balance

Janë pranuar 215 ankesave, nga të cilat 122 u zgjidhën dhe u zbatuan në STP, deri në 87 ankesa u zgjidhën, por nuk u zbatuan në STP për shkak të mosfunksionimit të programit të ri Protax.

## 6) Sektori i Pasurisë komunale

Gjatë periudhës Korrik–Dhjetor 2025 janë realizuar të gjitha objektivat e parapara nga ana e Drejtorisë.

Gjatë periudhës së lartpërmendur janë realizuar gjithsej 144 regjistrime, duke përfshirë regjistrimet e investimeve kapitale, si ato të përfunduara ashtu edhe investimet në vijim.

Po ashtu, gjatë kësaj periudhe janë bërë tre (3) kërkesa drejtuar Thesarit të Kosovës për lirim të investimeve në vijim, të cilat në sistemin SIMFK janë regjistruar si projekte të përfunduara.

Gjithashtu, nga ana e komisioneve të formuara për regjistrimin e pasurisë, është bërë regjistrimi i pasurisë me vlerë mbi 1000€, si dhe i pasurisë me vlerë nën 1000€, në të gjitha institucionet komunale, duke përfshirë shkollat, QKMF-në dhe QMF-të. Njëkohësisht është bërë pranimi dhe përpunimi i dokumentacionit përkatës të pranuar gjatë kësaj periudhe.

**Qamil Kolloni**



Drejtor i Drejtoriatit për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim - Komuna  
Dragash



Republika e Kosovës / Republika Kosovo  
Kuvendi Komunal Dragash / Skupština Opštine Dragaš  
Drejtorija për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike  
Direktorat za Zaštitu, Spašavanje i Javne Usluge



DATE/A:	23/01/2026
REFERENCE-E:	
PER/ZAT/TO:	Shërbimi i Kuvendit Zyre e Kryetarit të Komunës
CC:	
PËRMES/PREKO/TROUGHT:	Protokollit
NGA/OD/FROM:	Drejtorija për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike Redzep Ibraimi
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	 Raporti i punës së DMSHSHP-së për vitin 2025

Të nderuar, me këtë Ju dërgoj

## RAPORTI I PUNËS SË DMSHSHP-SË PËR VITIN 2025

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
Komuna e Dragashit  
Opština Dragaš

02 Nr. Br. 012/01-1736/26  
23.01.2026  
Dragash - Dragaš



## RAPORTI I PUNËS

### Drejtorati për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike për vitin 2025

#### I. Hyrje

Raporti vjetor mbi punën e Drejtoratit për vitin 2025 përfshin një pasqyrë të aktiviteteve të realizuara gjatë periudhës raportuese, në përputhje me kompetencat e Drejtoratit sipas Statutit të Komunës së Dragashit, vendimeve të Kuvendit Komunal të Dragashit, vendimeve dhe urdhrave të Kryetarit të Komunës, legjislacionit në fuqi, si dhe Planit të Punës së Drejtoratit për vitin 2025.

Raporti është hartuar në bazë të evidencës zyrtare të aktiviteteve, dokumentacionit administrativ dhe financiar, regjistrit të lëndëve zyrtare si dhe raporteve të Njesisë së Zjarrfikësve, dhe ka për qëllim të sigurojë një pasqyrë transparente dhe të qartë mbi punën e Drejtoratit për nevojat e Kryetarit të Komunës dhe Kuvendit Komunal.

Drejtorati në mënyrë të vazhdueshme ka ushtruar detyrat nga fusha e kompetencave të tij, në koordinim me drejtoritë e tjera komunale, ndërmarrjet publike dhe institucionet përkatëse.

Sa i përket bashkëpunimit me institucionet dhe partnerët, Drejtorati ka realizuar bashkëpunim intensiv me institucione vendore dhe ndërkombëtare:

- Implementimi dhe përfundimi i projektit GGP në bashkëpunim me Ambasadën e Japonisë.
- Bashkëpunim me KFOR-in, Ministrinë, komunat fqinje dhe partnerë të tjerë relevantë.
- Pjesëmarrje në takime, punëtori dhe dëgjime publike.

#### II. Shërbimi për ndërhyrje emergjente dhe zjarrfikëse

Me Planin e Punës për vitin 2025 është paraparë forcimi i kapaciteteve të Njesisë së Zjarrfikësve përmes avancimit të burimeve njerëzore, pajisjes teknike dhe gatishmërisë operative.

Në përputhje me këtë, gjatë vitit 2025 janë realizuar aktivitetet në vijim:

- Kryerja e vazhdueshme e detyrave operative të Njesisë së Zjarrfikësve në Dragash, duke përfshirë ndërhyrjet në zjarre, ndërhyrje teknike, sanimin e pasojave nga përmbytjet, reshjet e borës dhe situata të tjera emergjente.
- Mbajtja e evidencës dhe hartimi i raporteve të detajuara statistikore mbi ndërhyrjet e zjarrfikësve për periudha të ndryshme kohore, të cilat i janë dorëzuar Komitetit për Sigurinë e Komunitetit, strukturave komunale dhe partnerëve të jashtëm.
- Realizimi i aktiviteteve që lidhen me regjistrimin, sigurimin dhe kontrollin teknik të automjeteve zjarrfikëse, duke siguruar rregullsinë e plotë teknike dhe ligjshmërinë e përdorimit të tyre.
- Furnizimi me pajisje, karburant dhe materiale teknike për nevojat e Njesisë së Zjarrfikësve, në përputhje me mjetet e planifikuara.
- Fillimi dhe zhvillimi i procedurave administrative për punësimin e zjarrfikësve të rinj, në përputhje me Planin e Punës që parasheh rritjen e numrit të ekzekutuesve për shkak të mungesës së stafit ekzistues.
- Mbajtja e takimeve të rregullta me komandantin e Njesisë së Zjarrfikësve me qëllim analizimin e gjendjes, planifikimin e patrullimeve gjatë sezonit veror dhe përmirësimin e masave parandaluese.

Me qëllim të zvogëlimit të rrezikut për qytetarët dhe pronën, është i domosdoshëm veprimi i vazhdueshëm parandalues. Në përputhje me këtë, Drejtorati ka realizuar aktivitetet në vijim:

- Organizimi i vizitave parandaluese në zonat me rrezik në territorin e komunës së Dragashit.
- Përgatitja dhe shpërndarja e njoftimeve dhe thirrjeve drejtuar qytetarëve për ndalimin e ndezjes së zjarrit në hapësira të hapura, veçanërisht gjatë sezonit veror.
- Pjesëmarrja në punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) përmes takimeve të rregullta, raportimit dhe propozimit të masave parandaluese.
- Organizimi i ligjëratave dhe aktiviteteve edukative në shkolla, në bashkëpunim me Njësinë e Zjarrfikësve, me qëllim ngritjen e vetëdijes së fëmijëve dhe të rinjve për mbrojtjen nga zjarri dhe sjelljen në situata emergjente.

Gjatë vitit janë realizuar aktivitete që lidhen me hartimin e dokumenteve planifikuese dhe analitike në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit. Është iniciuar procedura për hartimin e dokumentit “Vlerësimi i rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera për Komunën e Dragashit”, përfshirë nisjen e procesit për formimin e grupeve punuese dhe bashkëpunimin me institucionet

përkatëse me qëllim grumbullimin e të dhënave të nevojshme, si dhe dorëzimin e raporteve dhe përgjigjeve ndaj institucioneve rajonale dhe shtetërore lidhur me planet e mbrojtjes nga përmytjet, rrëshqitjet e dheut dhe erozioni.

Gjatë vitit 2025, në territorin e komunës janë regjistruar gjithsej 101 zjarre të karaktereve të ndryshme. Numri më i madh i ndërhyrjeve është evidentuar gjatë muajve të verës, veçanërisht në Korrik, Gusht dhe Shtator, gjë që është e pritshme duke pasur parasysh kushtet klimatike dhe rritjen e rrezikut nga zjarret fushore dhe pyjore. Zjarret kanë përfshirë objekte banimi, sipërfaqe pyjore dhe bujqësore, objekte ndihmëse, deponi, si dhe infrastrukturë elektro-energjetike. Falë reagimit në kohë të Njësisë së Zjarrfikësve, është parandaluar një dëm më i madh material dhe janë shpëtuar jetë njerëzish.

Përveç kësaj, janë realizuar 93 shërbime dhe ndërhyrje teknike, të cilat kanë pasur të bëjnë me ofrimin e ndihmës së drejtpërdrejtë për qytetarët në terren, masa parandaluese dhe ndërhyrëse, si dhe bashkëpunim me institucione të tjera kompetente. Këto kanë përfshirë asistencë në aksidente trafiku, largimin e pengesave, sanimin e pasojave nga fatkeqësitë natyrore dhe situata të tjera që kanë kërkuar veprim urgjent të shërbimeve të mbrojtjes dhe shpëtimit.

Veçanërisht theksoj muajin Tetor, kur për shkak të kushteve të pafavorshme atmosferike dhe rritjes së numrit të kërkesave, është shënuar numri më i madh i këtyre ndërhyrjeve.

<b>Muaji</b>	<b>Zjarret (gjithsej)</b>	<b>Ndërhyrjet teknike</b>	<b>Shërbimet e qytetarëve</b>	<b>Gjithsej intervenime</b>
Janar	4	1	2	7
Shkurt	3	1	3	7
Mars	7	1	1	9
Prill	6	3	3	12
Maj	3	1	1	5
Qershor	4	1	2	7
Korrik	28	1	21	50
Gusht	16	0	7	23
Shtator	16	1	7	24
Tetor	2	11	11	24
Nëntor	5	3	2	10
Dhjetor	7	1	8	16

<b>Gjithsej</b>	<b>101</b>	<b>25</b>	<b>68</b>	<b>194</b>
-----------------	------------	-----------	-----------	------------

*Paraqitje tabelare e ndërhyrjeve sipas muajve për vitin 2025*

<b>Lloji i zjarrit</b>	<b>Nr.</b>
Zjarre pyjore	32
Zjarre fushore	35
Objekte banimi	14
Objekte ndihmëse (stalla, garazhe)	7
Deponi	6
Objekte elektro-energjetike (kabinete, trafo)	6
Objekte afariste	1
<b>GJITHSEJ</b>	<b>101</b>

*Paraqitja tabelare e strukturës së zjarreve sipas llojit në nivel vjetor*

### **III. Shërbimet Publike**

#### **1. Menaxhimi i mbeturinave**

Në përputhje me aktivitetet e planifikuara, Drejtorati gjatë vitit 2025 ka intensifikuar bashkëpunimin me kompaninë rajonale “Ekoregjioni” për zgjerimin e sistemit të mbledhjes së mbeturinave në vendbanime të reja, me masën konkrete për përfshirjen e 7 fshatrave të mbetur jashtë sistemit deri në vitin 2025 në sistemin e menaxhimit të mbeturinave.

Drejtorati gjithashtu ka organizuar shumë takime me qytetarët dhe këshillat e fshatrave me qëllim zgjidhjen e problemeve të hedhjes së mbeturinave.

Është kryer pranim-dorëzimi i kontejnerëve dhe përmirësimi i logjistikës së mbledhjes së mbeturinave, si dhe monitorimi i rregullt i realizimit të kontratave dhe përmbushja e obligimeve financiare ndaj ofruesve të shërbimeve.

#### **2. Ndriçimi publik**

Në përputhje me Pikën III të Planit të Punës – Përmirësimi i infrastrukturës dhe shërbimeve publike, janë ndërmarrë hapa për avancimin e sistemit të ndriçimit publik. Gjatë periudhës raportuese, Drejtorati ka:

- Regjistruar dhe përpunuar kërkesat e këshillave të fshatrave për marrjen e përgjegjësisë së pagesës së ndriçimit publik nga ana e Komunës.
- Komunikimi me kompaninë KEDS lidhur me vendosjen e matësve të rinj, ndryshimin e emrit të matësve dhe zgjidhjen e çështjeve teknike.
- Përgatitur vendime dhe akte që rregullojnë pagesën dhe mirëmbajtjen e ndriçimit publik.
- Përbushur rregullisht detyrimet lidhur me konsumimin e energjisë elektrike.

### **3. Furnizimi me ujë, kanalizimi dhe kroje publike**

Sa i përket furnizimit me ujë dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës, Drejtorati gjatë vitit 2025 ka realizuar një sërë aktivitete në këtë fushë përmes bashkëpunimit të vazhdueshëm me KRU “Hidroregjioni” lidhur me furnizimin me ujë dhe mirëmbajtjen e rrjetit të kanalizimit, zgjidhjen e problemeve që lidhen me krojet publike, kontrollin e konsumit të ujit dhe përbushjen e obligimeve, si dhe përmes pjesëmarrjes në realizimin e projekteve kapitale për rehabilitimin e rrjeteve të ujësjellësit dhe kanalizimeve.

## **IV. Investimet kapitale**

Në përputhje me Programin e Investimeve Kapitale të Komunës së Dragashit për vitin 2025, Drejtorati ka marrë pjesë në planifikimin, koordinimin dhe raportimin për projektet kapitale të mëposhtme, të cilat lidhen drejtpërdrejt me fushat e shërbimeve publike, infrastrukturës komunale, mbrojtjes dhe sigurisë:

### **1. Ndriçimi Publik**

1. Ndërtimi i ndriçimit publik në qendër të fshatit Globoçicë, 004/621-25-1628-5-2-1
2. Ndërtimi i ndriçimit publik në qendër të fshatit Brrut, 011/621-25-2616-5-2-1
3. Ndërtimi i ndriçimit publik në qendër të fshatit Pllav (projekt dyvjeçar), 017/621-25-3211-5-2-1
4. Ndërtimi i ndriçimit publik në qendër të fshatit Kuklibeg (projekt dyvjeçar), 014/621-25-3035-5-2-1
5. Ndërtimi i ndriçimit publik në qendër të fshatit Rrencë, 039/621-25-4852-5-3-5
6. Mirëmbajtja e ndriçimit publik në territorin e Komunës së Dragashit (projekt trevjeçar), 069/621-25-7854-2-1-1
7. Ndërtimi i ndriçimit publik në qendër të fshatit Globoçicë – Faza 2, 076/621-25-8483-2-3-6

## **2. Furnizimi me ujë dhe kanalizimi**

- 1) Ndërtimi i kanalizimeve dhe ujësjellësit në qendër të fshatit Kapre, 15/621-25-3050-5-2-1
- 2) Rehabilitimi i ujësjellësit, kanalizimeve dhe kanaleve në të gjithë territorin e Komunës së Dragashit – projekt me kohëzgjatje 36 muaj, 022/621-25-3703-2-2-1
- 3) Ndërtimi i kanalizimeve në fshatin Zlipotok, 027/621-25-4200-5-2-1
- 4) Ndërtimi i ujësjellësit në fshatin Lubovishtë (Ri tenderim), 035/621-25-8951-5-2-1
- 5) Ndërtimi i kanalizimeve në fshatin Brezne (Projekt dyvjeçar), 071/621-25-8195-5-2-1
- 6) Rinovimi i rrjetit të kanalizimeve në fshatin Rapçë, 072/621-25-8343-2-3-6
- 7) Ndërtimi i kanalizimeve në fshatin Zym (Projekt trevjeçar), 080/621-25-8746-5-2-1

## **3. Mbrojtja nga vërshimet dhe rrëshqitjet e dheut**

1. Ndërtimi i mureve mbrojtëse në fshatin Mlikë, 003/621-25-1538-5-2-1
2. Ndërtimi i murit mbrojtës në fshatin Zaplluxhe (Projekt dyvjeçar) 037/621-25-6688-5-2-1
3. Rregullimi i përroit në fshatin Vraniç, 038/621-25-4956-5-2-1
4. Ndërtimi i mureve mbështetëse dhe mbrojtëse në fshatin Orçushë 058/621-25-6749-5-2-1
5. Ndërtimi i murit mbrojtës në fshatin Globoçicë, 074/621-25-8436-5-2-1
6. Ndërtimi i murit mbrojtës në Qollopek në fshatin Zym (Projekt trevjeçar), 080/621-25-8746-5-2-1
7. Ndërtimi i murit mbrojtës pranë Xhamisë në fshatin Brezne, 086/621-25-9772-5-3-6

## **V. Punët administrative dhe financiare**

Gjatë vitit 2025, Drejtoria ka kryer të gjitha punët administrative dhe financiare të nevojshme për funksionimin e pandërprerë:

- Hartimi dhe realizimi i planit vjetor financiar.
- Përpunimi, kontrolli dhe nënshkrimi i faturave.
- Përgatitja e raporteve, vendimeve, miratimeve dhe korrespondencës zyrtare.

## VI. Treguesit statistikore të punës

Përshkrimi	Nr.
Numri total i çështjeve të regjistruara	87
Çështjet e zgjidhura / miratuara	78
Çështjet në proces / të përcjellura	9
Numri i vendbanimeve të përfshira në aktivitetet	30+
Numri i partnerëve institucionalë	15+
Çështjet që lidhen me dëmet dhe vërshimet	
Vërshimet dhe reshjet	9
Zjarret	5
Rrëshqitjet dhe shpëputjet e dheut	4
Tjetër (kafshët, kanalizimi)	4
Aktivitete parandaluese dhe siguria e komunitetit	
Vizitat parandaluese në zonat me rrezik	5
Aktivitete edukative në shkolla	3
Thirrje dhe fushata parandaluese	Më shumë gjatë vitit
Pjesëmarrja në punën e KKSb-së	Në vazhdimësi

*Paraqitja tabelare e lendeve të drejtorisë*

### Shërbime publike dhe komunale

#### Ndriçimi publik

Lloj i kërkesës	Nr.
Marrja e përgjegjësisë për pagesën e ndriçimit publik	25
Vendosja e matësve të rinj	18
Ndryshimi i emrit / pronësisë së matësve	9
Çështje teknike dhe të tjera	6

#### Furnizimi me ujë dhe Kanalizimi

Lloji i kërkesës	Nr.
Furnizimi me ujë	10
Defekte në kanalizim	8
Çezmat dhe pompat publike	5

#### Menaxhimi i mbeturinave

Aktiviteti	Nr.	Vërejtje
Fshatrat e reja të përfshirë në sistem	7	Zgjerimi i mbulimit
Takime me këshillat fshatare	93	Punë në zyre dhe në terren
Aktivitetet në deponitë ilegale	Më shumë	Në varësi të fondeve

#### Projektet kapitale dhe ndërkombëtare

Fusha	Nr. i projekteve
Ndriçimi publik	4
Furnizimi me ujë dhe kanalizimi	3
Mbrojtja nga përmytjet dhe rrëshqitjet e dheut	Më shumë lokacione
Projektet ndërkombëtare (GGP)	1

#### Detyrat administrative dhe financiare

Aktivitetet	Vëllimi
Hartimi dhe realizimi i planit financiar	Vjetore
Përpunimi dhe kontrolli i faturave/kuponëve	Në vazhdimësi
Përgatitja e vendimeve, miratimeve dhe raporteve	80+ akte
Korrespondenca institucionale	Në vazhdimësi

## VII. Përfundimi

Aktivitetet e parashikuara me Planin e Punës së Drejtoratit janë realizuar në përputhje me dinamikën e planifikuar dhe burimet buxhetore të disponueshme. Drejtorati ka siguruar vazhdimësinë e punës, raportimin në kohë dhe mbështetjen institucionale për Kryetarin e Komunës dhe Kuvendin Komunal.

- Bazuar në të dhënat e paraqitura, konstatohet se Drejtorati gjatë vitit 2025:  
Ka realizuar shumicën e aktiviteteve të parashikuara me Planin e Punës për vitin 2025;
- Ka siguruar vazhdimësinë në ofrimin e shërbimeve publike dhe komunale;
- Ka përmirësuar sistemin e mbrojtjes dhe shpëtimit, si dhe veprimet parandaluese në territorin e komunës;
- Ka kryer aktivitete të rëndësishme administrative, financiare dhe projektuale në përputhje me kompetencat ligjore.

Aktivitetet që janë shënuar si pjesërisht të realizuara lidhen me procese shumëvjeçare dhe projekte kapitale, të cilat varen nga procedura shtesë, miratime ose burime financiare, dhe ato do të jenë objekt i monitorimit të mëtejshëm gjatë periudhës së ardhshme planifikuese.

**Dragash, Janar 2026**

**Redžep Ibraimi**



**Drejtor**

**Drejtorati për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike**



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA**  
**Komuna e Dragashit**  
**Opština Dragas**

*02 Nr. Bf. 052/04-3492/16*  
*15.02.2025*  
**Dragash - Dragas**

Republika Kosova/Republic of Kosovo  
Komuna Dragash/ Opština Dragas/ Dragas Municipality

**DREJTORIA PËR ARSIM**



<b>DATE / A</b>	31.12.2025
<b>REFERENCË</b>	13/880
<b>PËR:</b>	z. Bexhet Xheladini, Kryetar i Komunës në Dragash
<b>CC:</b>	z. Vetim Ramadani, Nënkrjetar i Komunës në Dragash z. Fejzal Halilovic, Nënkrjetar i Komunës në Dragash
<b>NGA:</b>	z. Zeni Krasniqi, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit në Dragash
<b>LËNDA:</b>	Raport i punës për vitin 2025

Drejtoria për Arsim në vitin 2025 ka realizuar aktivitetet e veta në kuadër të dinamikës dhe vëllimit të punës të përfshira në planin e veprimit për këtë vit. Realizimi i detyrave të punës është bërë në harmoni të plotë me Statutin e Kuvendit Komunal, Ligjin për arsimin para universitar të Republikën e Kosovës Nr.04/L-032 dhe Udhëzimeve Administrative të nxjerra nga MASHT-i.

Në komunën tonë funksionale janë 37 objekte shkollore dhe atë:

Shkolla AMË	Shkolla Paralele të ndara	SHML – Mesme e lartë	Qerdhe
12	23	1	1

Të gjitha këto shkolla janë në kuadër të arsimit publik ngase në territorin e komunës së Dragashit nuk funksionon asnjë shkollë private.

Vlen të theksohet se, qerdhja në Dragash është funksionalizuar, ka startuar me gjithsej 63 fëmijë, moshë 3-5 vjet.

**Procesi arsimor është i organizuar në këto nivele:**

1. QBK - Qendër me bazë në Komunitet, moshë 3-5
2. Qerdhe, moshë 3-5 vjet
3. Arsim para fillor - organizohet me qëllim të përgatitjes së fëmijëve për vazhdimin e shkollës fillore dhe funksionon në kuadër të objekteve të shkollave fillore, moshë 5-6 vjeç
4. Arsim fillor – në kuadër të këtij niveli përfshihen klasat **1-5** moshë, 6 deri në 10 vjeç

5. Arsimi i mesëm i ulët - përfshin klasat 6-9 mosha, 11 deri në 14 vjeç
6. Arsimi i mesëm i lartë – përfshinë klasat 10 – 12 mosha, 15 – 17 dhe është i organizuar në:
  - Arsimin e përgjithshëm (gjimnaz),
  - Arsimin profesional.

Kohëzgjatja e këtij niveli është 3 vjet varësisht nga profilet arsimore të përcaktuara nga MASHT-i.

Në Drejtorinë për Arsim punojnë 6 punëtorë përfshirë edhe drejtorin e drejtorisë, kurse në të gjitha nivelet arsimore janë të angazhuar 436 punëtorë nga të dy komunitetet. Në këtë vit shkollor numri i nxënësve në institucionet edukative-arsimore të komunës së Dragashit është. 2779

- QBK (Qendra me bazë në komunitet) - parashkollor 63 nxënës,

- arsimin parafillor 220 nxënës,

- fillor 2122 nxënës

- të mesëm 374 nxënës.

Vitin shkollor **2024/25** e kanë ndjekur 2779 nxënës, të grupuar në **23** paralele, të shpërndarë në:

12 Shkolla Filllore të Mesme të Ulëta;

23 Paralele të ndara të Shkollave Filllore;

**1** Shkollë të Mesme të Lartë (Mikse);

**1** Qerdhe;

Gjatë punës një vjeçare janë punuar 908 lëndë administrative të cilat janë paraqitur sipas kërkesave e nevojave të shkollave, punëtorëve dhe organeve komunale.

- Vendime për ndryshime – kthim nga lehonja, kalimi në pushim lehonie,
- Vendim për largim – skadim kontrate, pensionim,
- Kërkesa, përgjigje, ankesa, pëlqime etj....

Janë realizuar aktivitete kulturo-artistike me rastin e shënimit të ditëve të shkollave.

Drejtorja e Arsimit ka bërë mbikëqyrjen e procesit edukativo-arsimor, mbikëqyrje e cila është duke u realizuar në vazhdimësi nga drejtori dhe zyrtarët komunal të arsimit;

Sipas dinamikës së planifikuar, drejtori së bashku me zyrtarë kanë realizuar planin operues, si: vizita informuese, speciale, kontrolluese dhe të përgjithshme në institucionet e arsimit, përkatësisht në shkollat fillore të mesme të ulëta dhe në shkollën fillore të mesme të lartë në komunën e Dragashit. Në kuadër të mbikëqyrjes profesionale dhe kontrollit të vazhdueshëm të ecurive dhe zhvillimeve në procesin e institucioneve edukativo-arsimore të komunës së Dragashit, zyrtarët e Drejtorisë së Arsimit sipas planifikimit dhe dinamikës së paraparë gjatë këtyre muajve, kanë realizuar vizita speciale dhe kontrolluese në institucionet arsimore.

- Është bërë kompletimi dhe dërgimi i të dhënave në MASHT me qëllim të publikimit të konkursit për regjistrim të nxënësve në klasën e dhjetë, në SHML (Shkollën e Mesme të Lartë) dhe përcjelljen e procedurës së regjistrimit të nxënësve në shkollën e mesme të lartë.
- Përgatitja dhe regjistrimi i nxënësve të klasave para fillore dhe parashkollore.
- Përgatitja për regjistrimin e nxënësve në klasën e parë.
- Shpallja e konkursit të rregullt për plotësimin e vendeve të lira të punës, mësimdhënës, punëtorë teknik, formimi i komisionit për rekrutim, vlerësimi dhe përzgjedhja e personelit arsimor në bazë të konkursit të rregullt sipas UA (udhëzimit administrativ). Si dhe janë shpallur edhe konkurse tjera plotësuese.
- Furnizimi i shkollave me dokumentacion pedagogjik: ditarë pune, librat të kujdestarisë si dhe kalendarin shkollor.
- Përcjellja e punës së shkollave për realizimin e ekskursioneve të maturantëve dhe semimaturantëve.
- Furnizimi i të gjitha shkollave me lëndë djegëse dhe materiale tjera.
- Përgatitja e raportit për suksesin dhe rezultatet e nxënësve të arritura në tri nivelet e arsimit parauniversitar .
- Është marrë raporti nga SMIA **për gjendjen fizike të shkollave**, shkollat e pajisura me kamera, trethoja, laborator, biblioteka, klasa të zakonshme, klasa të pajisura me mjete elektronike; projektor, tabela .....
- Objektet me masa të Efiqjencës së energjisë me panele solare, janë: SHFMU “ 28 NËNTORI “ – Brodosanë dhe SHFMU “ Ilmi Bahtijari “ – Blaç.

\* Në Shkollat Restelicë dhe Kërstec projekti është dy vjeçar, dmth (2 shkolla) pjesërishtë me masa të efijqencës së energjisë

\* 21 shkolla plotësisht të paisura me efijqencë të energjisë:

( Krushevë, Brod, Radesh, Lybevishtë, Rapçë, Shajne, Pllajnik, Kosavë, Kuk, Kapre, Brodosanë, Blaç, Zaplluxhe, Zgatar, Brrut, Bellobrad, Zym, Rrenc, Brezne, Buge dhe Plavë).

- Numrin e të punësuarve në IA në dy komunitete 436, edukator, mësues klasor, ars. Lëndor, profesor, punëtor teknik, administrat.

- Është mbajt Olimpiada e gjuhës shqipe për 2025

- Olimpiada e Fizikës,

- Olimpiada e Matematikës dhe

- Olimpiada e Kimisë për 2025

### Testi i Arritshmërisë për vitin 2025

Nga gjithsej 213 semimaturant të planifikuar nga 11 shkolla filllore, 7 shkolla Shqipe dhe 4 shkolla të komunitetit boshnjak, testit i nënshtuan 211 nxënës. Organizimi i këtij testi është bërë në një qendër testimi: në SHML “Ruzhdi Berisha” - Dragash.

U mbajt me datë: 27.06.2025 në SHML” Ruzhdi Berisha “ me gjithsej 15 paralele, 13 në gjuhën shqipe dhe 2 në gjuhën boshnjake.

Prezent kanë qenë organet e sigurisë, mjeku kujdestar, komisionarët nga MASHT: Shaqir Alija dhe Shukri Smaili dhe stafi nga DKA.

22 Administrues të komunës tonë, administruan testin.

Nga DKA është siguruar, transporti i nxënësve, lapsat, ujë dhe bexhet për administruesit.

### Niveli i përgjithshëm i arritshmërisë

Shkolla	Nr i nxënësve që i nënshtrova testit të arritshmërisë	M	F	% e arritshmërisë	M%	F%
SHML “ Ruzhdi Berisha “	211	112	99	52.08	53.08 %	46.91 %

Nr.	Emri i shkollës	Nr. Nxënësve	Gj. Amtaare	Gj. Angleze	Histori	Gjeografi	Matematikë	Informatikë	Fizikë	Kimi	Biologji	Totali
1	SHFMU: "ILMI BAHUJARI"	30	52.0%	31.3%	43.8%	39.2%	37.0%	45.5%	37.1%	39.7%	34.8%	40.5%
2	SHFMU: "28 NENTORI"	41	49.0%	42.0%	51.4%	53.7%	46.5%	47.3%	49.1%	36.6%	42.0%	47.3%
3	SHFMU: "SAMIDIN EMINI"	19	52.9%	32.6%	59.5%	51.8%	55.5%	52.6%	52.6%	40.8%	35.7%	50.6%
4	SHFMU: "ULINA"	11	54.5%	40.0%	58.7%	66.7%	70.0%	67.3%	55.7%	53.4%	63.6%	60.4%
5	SHFMU: "SEZAI SURROI"	26	53.8%	39.2%	63.0%	45.8%	47.3%	50.8%	44.7%	38.5%	40.6%	48.7%
6	SHFMU: "SHABAN SHABANI"	24	49.8%	31.3%	55.2%	47.8%	46.5%	41.7%	44.0%	37.5%	41.5%	46.1%
7	SHFMU: "FETAH SYLEMANI"	40	54.1%	34.0%	61.3%	51.7%	44.6%	50.5%	40.6%	35.0%	43.3%	48.1%
8	SHFMU: "FETAH SYLEMANI"	4	75.0%	60.0%	66.7%	50.0%	53.3%	73.3%	45.8%	50.0%	40.7%	43.8%
9	SHFMU: "RESTELICA"	10	53.0%	30.0%	30.8%	34.2%	38.5%	48.0%	31.3%	25.0%	36.7%	38.1%
10	SHFMU: "SVETLOST"	6	61.7%	23.3%	60.3%	50.0%	44.2%	53.3%	47.9%	41.7%	40.7%	49.7%
11	SHFMU: "25 MAJI"	1	80.0%	80.0%	61.5%	50.0%	55.0%	80.0%	50.0%	37.5%	66.7%	62.0%
12	SHFMU: "9 MAJI"	1	85.0%	60.0%	84.6%	83.3%	45.0%	60.0%	62.5%	50.0%	33.3%	65.0%
13	SHFMU: "ZENUINI"	1	70.0%	40.0%	61.5%	41.7%	60.0%	80.0%	37.5%	37.5%	44.4%	55.0%
Gjithsej:		214	60.8%	41.8%	58.3%	51.2%	49.5%	57.7%	46.1%	40.2%	43.4%	50.4%

### Matura Shtetërore për vitin 2025

U organizua në SHML “Ruzhdi Berisha”, me gjithsej **101** maturantë. Administrimin e testit e kanë bërë mësimmhënësit e komunës së Prizrenit. Në klasa kanë qenë deri në 15 nxënës për klasë. DKA-ja i ka kryer të gjitha përgatitjet e nevojshme teknike me përpikëri. Testi ka filluar dhe ka përfunduar me kohë dhe nuk ka pasur asnjë problem. Përqindja e kalueshmërisë

Shkolla	Nr.i nxënësve që iu nënshtrova testit	M	F	Kaluan	<b>Nuk kaluan</b>	% e kalueshmërisë	M %	F %
Ruzhdi Berisha	MATURA 2025							
Gjithsej	101	63	38	67	34	66.33 %	62.37 %	37.62

- Numri i nxënësve që mbaruan klasën e 12-të **101** nxënës
- **67** nxënës e kaluan testin me, **66.33%**
- Nr i nxënësve femra **38** me **37.62 %**
- Nr. i nxënësve meshkuj **63** me **62.37**
- **12** shkollat kanë dorëzuar raportet dy herë në vit.
- Të gjitha shkollat e komunës tonë janë të paisura me kamera.

- Për këtë vit nuk kemi braktisje të shkollës nga nxënësit.
- Orët e planifikuara për këtë vit shkollor kanë qenë **18485, gjithësej u realizuan, mbajtën 17533 orë mësimore, kurse nuk u realizuan 952 orë mësimore.**
- Kemi **4** nxënës me nevoja të v.a.
- Këtë vit shkollor nuk kemi pas kërkesë për vlerësim të nxënës me n.v.a.
- Kemi vetëm **3** asistente për f.n.v.a, andaj kemi kërkesa nga drejtorët e shkollave për Asistent për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore në Blaç, Kuk, Llopushnik, Bresanë, Kosavë, Bellobrad edhe SHML.

Me kërkesë të Policisë së Kosovës - Dragash, janë mbajtur ligjëratat, për masat dhe sigurimin e një ambienti të sigurt në shkollat e komunës së Dragashit dhe dokumentarë për vetëdijësim mbi rreziqet e lëndëve narkotike dhe pasojat shëndetësore, shogërore dhe ligjore" dhe "Ruajtja e Ambientit dhe Trashëgimisë Kulturore".

Gjithashtu vazhdon bashkëpunim i mirëfilltë me organizatat të ndryshme siç janë: UNICEF, Caritasin Zvicërran, Ambasada Amerikane, JICA si dhe CIMIC-u Italian, Avoko, ECMI dhe Kfori turk, VOLONTARI NEL MONDO RTM me DKA-në, nënshkruan Marveshje Mirëkuptimi për zhvillim profesional të edukatoreve.

Marrveshje bashkëpunimi, me UNICEFIN ka vazhduar Qendra me Bazë në Komunitet në fshatin Brodosanë, me dy paralele me fëmijë të moshës 3-5 vjeç. 3 edukatore, me këtë grup moshë janë sistemuar në listën e pagave bazuar në marrëveshjen e mirëkuptimit në mes të kryetarit të komunës.

Drejtorja e Arsimit në Dragash po ashtu ka ndarë edhe bursa për studentet të Komunës së Dragashit, 114 bursa studentore.

Në këtë vit janë punësuar 20 punëtor, mësimdhënës, punëtor teknik.

Drejtorja e Arsimit i ka plotësuar këto vende duke i zhvilluar procedurat e rekrutimit duke u bazuar në Ligjet dhe Udhëzimet Administrative që e rregullojnë këtë fushë.

Gjatë këtij viti janë mbajtur trajnime me mësimdhënës të të gjitha shkollave, të organizuara nga SBASHK-u. Me temën “ Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” .

## **SFIDAT PËR VITIN 2025**

1. Zëvendësimi i personelit arsimor (procedurat e stërzgjatura), problemet e pagesës
2. Rënia e numrit të nxënësve, (rënia e numrit të orëve).
3. Problem i pagesës së shujtave, (përmbaruesi)
4. Problem i pagesës së licencës së mësimdhënësve, (përmbaruesi)
5. Kërkesat për pushim pa pagesë për mësimdhënës,
6. Sistemi paralel
7. Aktivizimi i Ekipit për vlerësim pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore
8. Trajnimi i mësimdhënësve i cili është kusht për Licencë të mësimdhënies
9. Nevoja për asistent për fëmijë me nva .

## **REKOMANDIMET**

- Dezinfektimi dezinfektimi dhe deratizimi i shkollave .
- Angazhimi i drejtoreshave të shkollave për përgatitjet rreth fillimit të vitit të ri shkollor 2025/2026.
- Më shumë përgjegjësi për drejtorat e shkollave.

## Investimet kapitale dhe mirëmbajtja në shkollat e Komunës së Dragashit për vitin 2025

Nr.	Investimet kapitale 2025
1.	Renovimi i shkollës fillore në fshatin Restelicë
2.	Ndërtimi i tereneve sportive në shkollat fillore: Krushev, Zllipotok, Gillobogic (projekt dy vjeçar)
3.	Ndërtimi i këndit të lojërave, kubëzimi, demolimi i shkollës së vjetër në fshatin Bresanë, në shkollën “28 Nëntori”
4.	Ndërtimi i nryeve sanitare dhe hapësirës multifunksionale në shkollën e mesme “Ruzhdi Berisha” (dy vjeçar)
5.	Rehabilitimi i ngrohjes në shkollën “Ulina”, në Kosovë
6.	Mirëmbajtja dhe furnizimi me inventar i çerdhes në Dragash
7.	Mirëmbajtja e katër klasëve të shkollës së vjetër në shkollën “28 Nëntori”, në fshatin Bresanë (projekt dy vjeçar)
8.	Renovimi i kabinetit të mjekësisë në SHML “Ruzhdi Berisha”, në Dragash
9.	Mirëmbajtje e shkollave: “28 Nëntori”, “Sezai Surroi”, “Ulina”, “Ilmi Bahitjari”, “Samidin Emiri”, Ruzhdi Berisha
10.	Mirëmbajtje e objekteve sportive (zhveshtorët e stadiumit të qytetit)

## Furnizimet në shkollat e Komunës së Dragashit për vitin 2025

Nr.	Furnizimet
1.	Furnizim me pelet (projekt 3 vjeçar – 2024/2025/2026), për shkollat: Fetah Sylejmani (Qendra, çerdhja dhe shkolla në Shajne) dhe Svetlost
2.	Furnizime me dru për gjitha shkollat fillore
3.	Furnizime me naftë të ngrohjes qendrore për shkollën e mesme “Ruzhdi Berisha”
4.	Furnizime pastrimi (higjienë)
5.	Furnizime me kompjuterë për nevojat e shkollës dhe komunës
6.	Furnizim me kalldaj për shkollën fillore “Fetah Sylejmani”, në Dragash (projekt dy vjeçar)
7.	Furnizim me ditarë për gjitha shkollat
8.	Shërbime zërimi (për rastin e ditëve të shkollës)
9.	Furnizime me pije dhe ushqim (jo dreka zyrtare), për rastin e ditës së shkollave

## Transportit i nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme për vitin 2025

Nr.	Transporti
1.	Transporti i nxënësve të shkollave fillore (Buçe, Brezne, Pllavë-Llopushnik)
2.	Transporti i nxënësve të shkollave fillore (Zgatar, Zaplluxhe-Blaç)
3.	Transporti i nxënësve të shkollave fillore (Zym, Kapre, Brrut-Bellobrad)
4.	Transporti i nxënësve të shkollave fillore (Rrenc-Drash)
5.	Transporti i nxënësve të shkollës së mesme (Zaplluxhe-Drash: <i>Blaç, Zgatar, Brrut, Bellobrad dhe Zym</i> )
6.	Transporti i nxënësve të shkollës së mesme (Restelicë-Drash)
7.	Transporti i nxënësve të shkollës së mesme (Prizren-Drash ose Spital te shkolla)
8.	Transporti i nxënësve të shkollës së mesme (Bresanë-Drash: <i>Kukitbeg, Kapre, Kosovë, Kuk, Buzez, Pllajnik</i> )
9.	Transporti i nxënësve të shkollës së mesme (Brezne, Buçe, Pllavë, Rrencë-Drash)
10.	Transporti i nxënësve të shkollës fillore (Buzes-Bresanë)
11.	Transporti i nxënësve të shkollës fillore (Pllajnik-Kosovë)
12.	Transporti i nxënësve të shkollës fillore (Xërxe-Drash)

## ÇËSHITJE TJERA

DKA do të punoj vazhdimisht për krijimin e kushteve sa më të mira në të gjitha shkollat e Komunës sonë, duke menduar gjithmonë më të mirën për të gjithë nxënësit.

**31.12.2025**

Drejtori i DKA-së





Republika e Kosoves  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunes Dragash  
Skupština Opštine Dragaš  
Municipal Assambly Dragas

Drejtorati per urbanizem, kadaster dhe mbrojtje te mjedisit  
Direktorijati za urbanizam, katastar i zaštitu sredine  
Directorate for urbanism, cadastre and environment protectiona

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
Komuna e Dragashit  
Opština Dragaš

## RAPORTI I PUNËS

### PËR VITIN 2025

02 Nr. Br. 052/01-3674/26  
27.02.2026  
Dragash - Dragaš

Të nderuar,

Duke u nisur nga detyrat konkrete të përfshira në Planin e Punës për vitin 2025, Buxheti i Komunës së Dragashit për vitin 2025, ligjet në fuqi, udhëzimet administrative dhe instruksionet e ministrive përgjegjëse dhe të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, si dhe bazuar në Urdhërin e drejtorit nr. 06 br.052/01-2650/26 të datës 09.02.2026, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastrën dhe Mbrojtjen e Mjedisit paraqet si në vijim:

#### RAPORT PËR PUNËN PËR VITIN 2025

Puna e Drejtorisë gjatë vitit 2025 u zhvillua në përputhje me:

- Ligjin për ndërtim
- Ligjin për planifikim hapësinor
- Ligjin për kadastrën e pronave të paluajtshme nr. 08/L-237
- Ligjin për procedurën administrative të përgjithshme
- Ligjin për mbrojtjen e mjedisit
- Ligjin për vetëqeverisjen lokale
- Ligjin për Parkun Kombëtar "Shar"
- Udhëzime administrative relevante
- Statutin e Komunës së Dragashit
- Planin e punës për vitin 2025
- Buxhetin e Komunës së Dragashit për vitin 2025

## **I. ORGANIZIMI DHE METODOLOGJIA E RAPORTIMIT**

Bazuar në Urdhrin e drejtorit, të gjithë punonjësit e Drejtorisë ishin të detyruar të dorëzonin raportet vjetore të punës dhe planet e punës.

## **II. SEKTORI I URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSOR**

### **1. REALIZIMI I INVESTIMEVE KAPITALE PËR VITIN 2025**

Kur bëhet fjalë për realizimin e investimeve kapitale për vitin 2025, konstatohet sa vijon:

- Buxheti total për investimet kapitale për vitin 2025 ishte: 4.348.660,32 €
- Shumat e realizuara gjithsej: 3.880.559,03 €
- Përqindja e realizimit: 89,24 %

Bazuar në analizën e kryer, mund të përfundohen se realizimi i buxhetit kapital ka qenë në një nivel të lartë, duke marrë parasysh rrethanat objektive që ndikuan në dinamikën e realizimit.

Projektet e pa-realizuara

Nga të gjitha projektet e planifikuara për vitin 2025, nuk u realizuan projektet e mëposhtme:

1. Kubëzimi i rrugëve në fshatin Pllavë;
2. Ndërtimi i kanalit për ujërat atmosferikë në fshatin Kuklibeg;

Projektet në proces ankimimi

Projekti:

1. Ndërtimi i mureve mbajtëse në Peterc dhe kubëzimi i qendrës së fshatit Radeshë, me vlerë prej 70.000 €  
gjendet në proces ankimimi para OSHP – Prishtinë, pas ankimit të operatorëve ekonomikë, gjë që ndikoi në realizimin e tij në vitin 2025.

Ndikimi i ekzekutimeve gjyqësore mbi buxhetin:

Gjithashtu, realizimin e projekteve kapitale e ndikoi pagesa e detyrueshme sipas vendimeve gjyqësore, e kryer përmes Thesarit Qendror në vlerë totale prej 262.803,76 €.

Pagesat janë kryer bazuar në marrëveshjet kolektive në sektorët:

- Arsimi
- Shëndetësia

Gjë që shtoi barrën mbi realizimin buxhetor të investimeve kapitale.

### **1. PUNA E SEKTORIT TË URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSOR**

Gjatë vitit 2025, Sektori i Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor ka vepruar sipas kërkesave të palëve në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **1. Lejet ndërtimore**

- Kërkesa të pranuar dhe të shqyrtuara: 6

- të aprovuara: 5
- të refuzuara: 1

## 2. Kushtet ndërtimore

- Gjithsej të zgjidhura: 11

- të aprovuara: 10
- të refuzuara: 1

## 3. Legalizimi i objekteve pa leje

- Gjithsej kërkesa: 15

- të aprovuara: 8
- në pritje: 7
- të refuzuara: 0

## 4. Parcelat urbane

- Gjithsej kërkesa: 6

- të aprovuara: 6
- të refuzuara: 0

## 5. Certifikatat e pëlqimit dhe vërtetime të tjera

Spektori i Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor:

- ka pranuar kërkesa: 28

- të aprovuara: 24
- të refuzuara: 4

## 2. VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM

Bazuar në të dhënat e paraqitura, mund të konstatohet se Spektori i Urbanizmit gjatë vitit 2025 ka punuar në mënyrë efikase, me përqindje të lartë të kërkesave të aprovuara dhe me zhvillim të rregullt të procedurave administrative në përputhje me ligjin, si dhe me një nivel të lartë të realizimit të buxhetit për investime kapitale prej **89.25%**.

## III. ZYRA KOMUNALE KADASTRALE (ZKK)

Zyra Komonale Kadastrale (ZKK) Dragash gjatë vitit 2025 ka vepruar në përputhje me **Ligjin për Kadastrën e Pronave të Paluajtshme, Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative**, si dhe me udhëzimet administrative dhe instruksionet e **Agjencisë Kadastrale të Kosovës**.

Puna e ZKK-së ka qenë e orientuar në:

- pranimin dhe përpunimin e kërkesave të qytetarëve,

- realizimin e ndryshimeve në hartën kadastrale,
- lëshimin e dokumenteve kadastrale,
- përpunimin digjital të lëndëve përmes sistemeve **e-Kadastër** dhe **e-Geometër**,
- zvogëlimin e numrit të lëndëve të mbetura (të pazgjidhura).

### **1. Numri i përgjithshëm i kërkesave të pranuara**

Gjatë periudhës **01.01.2025 – 31.12.2025**, zyra e pranimit e **ZKK Dragash** ka pranuar gjithsej:

#### **2.681 kërkesa**

Ky numër tregon një vëllim të shtuar të punës dhe një kërkesë të vazhdueshme të qytetarëve për shërbime kadastrale.

### **2. Struktura e kërkesave sipas llojeve të shërbimeve**

**Ndryshimet në evidencën kadastrale – RPNI** (Regjistri i të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme).

<b>Lloji i shërbimit</b>	<b>Numri i kërkesave</b>
Transferimi i pronësisë – shitblerje	151
Transferimi i pronësisë – dhuratë	134
Transferimi i pronësisë – trashëgimi	97
Ndarja e parcelave	144
Transferimi i pronësisë – ndarje fizike	22
Ndryshimi i të dhënave personale pa njësi kadastrale	35
Regjistrimi i pronësisë sipas aktgjykimit dhe bazave të tjera	34
Regjistrimi i pjesëve të objektit	2
Regjistrimi i objektit	4
Bashkimi i parcelave	34
Transferimi i pronësisë – shkëmbim	5
Bashkimi i personave me ID të ndryshëm	76

Lloji i shërbimit	Numri i kërkesave
Kërkesë për regjistrimin e shënimit nga përmbaruesi	3

### 3. Vërtetimet dhe dokumentet kadastrale të lëshuara

Lloji i dokumentit	Numri
Vërtetim se personi nuk posedon pasuri të paluajtshme	350
Fletë posedimi (certifikatë)	1.436
Certifikatë dhe kopje e planit	76
Kopje e planit me koordinata	63
Historiku i parcelës	15

### 4. Metodologjia e punës

Metodologjia e punës së **ZKK Dragash** është bazuar në:

- të dhënat nga librat protokollare,
- sistemin elektronik **SIKTK** të Agjencisë Kadastrale të Kosovës,
- sistemet **e-Katastar** dhe **e-Geometar**,
- aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

### 5. Vlerësimi i përgjithshëm i punës së ZKK

Bazuar në të dhënat e paraqitura mund të konstatohet se **Zyra Komunale Kadastrale e Dragashit** gjatë vitit 2025:

- ka punuar me një vëllim të shtuar të lëndëve,
- ka siguruar ofrim të vazhdueshëm të shërbimeve për qytetarët,
- ka përmirësuar përpunimin digjital të lëndëve,
- ka ruajtur një nivel të lartë të efikasitetit administrativ.

## IV. SHËRBIMI PËR SISTEMIN E ADRESAVE

Gjatë vitit **2025**, Shërbimi për Sistemin e Adresave në kuadër të **Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtjen e Mjedisit** ka vazhduar punën intensive për zbatimin dhe përmirësimin e sistemit të adresave në territorin e **Komunës së Dragashit**.

## **1. Implementimi i Sistemit të Adresave (ARIS)**

Gjatë vitit **2025** është vazhduar puna në projektin e **Sistemit të Adresave**, i cili realizohet në bashkëpunim me **Agjencinë Kadastrale të Kosovës (AKK)**.

Në bashkëpunim me stafin profesional dhe me mbështetjen e ekspertit të angazhuar nga **AKK**, janë arritur rezultate të rëndësishme.

### **Rezultati kryesor:**

Mbi **30.000 qytetarë të Komunës së Dragashit** kanë konfirmuar adresën e tyre zyrtare përmes sistemit **ARIS**.

Ky rezultat përfaqëson një përfshirje rekord në nivel komunal dhe përmirëson ndjeshëm saktësinë e regjistrit të adresave.

## **2. Vlerësimi i përgjithshëm**

Bazuar në rezultatet e arritura mund të konstatohet se **Shërbimi për Sistemin e Adresave** gjatë vitit **2025**:

- ka arritur një nivel të lartë të realizimit të aktiviteteve,
- ka përmirësuar ndjeshëm regjistrin e adresave të komunës,
- ka siguruar një përfshirje të gjerë të qytetarëve,
- ka ofruar mbështetje profesionale për **Zyrën e Regjistrit Civil në Komunën e Dragashit**.

## **V. SEKTORI I MBROJTJES SË MJEDISIT**

Gjatë vitit **2025**, Sektori i Mbrojtjes së Mjedisit në kuadër të **Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtjen e Mjedisit** ka realizuar aktivitetet në përputhje me kompetencat ligjore, **Planin e punës për vitin 2025** dhe udhëzimet administrative relevante.

### **1. Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave për leje ekologjike**

Gjatë vitit **2025**, sektori ka bërë pranimin, shqyrtimin dhe përpunimin e kërkesave për **leje komunale mjedisore (LMK)**, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Procedura ka përfshirë:

- verifikimin administrativ të kërkesave,
- inspektive në terren,
- verifikimin e dokumentacionit përcjellës,
- lëshimin e lejeve për operatorët ekonomikë kompetentë.

Këto aktivitete janë realizuar plotësisht në përputhje me ligjin dhe procedurat administrative.

## 2. Kontrollat në terren dhe verifikimi i kushteve

Gjatë periudhës raportuese janë realizuar inspektive të rregullta në terren me qëllim të:

- verifikimit të kushteve mjedisore,
- kontrollit të parametrave urbanistikë,
- monitorimit të përputhshmërisë së aktiviteteve me rregullat e mbrojtjes së mjedisit.

Në këtë mënyrë është siguruar mbikëqyrje e vazhdueshme ndaj aktiviteteve që mund të kenë ndikim në mjedisin në territorin e komunës.

## 3. Raporti për performancën komunale

Spektori ka përgatitur dhe dorëzuar **raportin për performancën komunale** brenda afatit të përcaktuar.

Bazuar në vlerësimin e realizuar:

- Drejtoria ka arritur **pikët maksimale** në fushat për të cilat ka qenë përgjegjëse,
- raportimi është realizuar në mënyrë **cilësore dhe me kohë**.

## 4. Realizimi i planit të prokurimit publik

Plani i prokurimit publik për nevojat e **Sektorit të Mbrojtjes së Mjedisit** gjatë vitit 2025:

- është realizuar në tërësi,
- është zbatuar pa vonesa,
- pa procedura të refuzuara.

## 5. Monitorimi i aktiviteteve me ndikim në mjedis

Spektori ka kryer monitorim të vazhdueshëm të aktiviteteve që kanë ndikim në mjedis, në përputhje me standardet në fuqi.

Fokus i veçantë ka qenë në:

- bashkëpunimin me organizata ndërkombëtare dhe lokale joqeveritare,

- pjesëmarrjen në aktivitete të përbashkëta mjedisore,
- forcimin e mbikëqyrjes institucionale.

## 6. Koordinimi me MMPHI

Gjatë vitit 2025 është realizuar bashkëpunim aktiv me **Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI)**.

### Rezultatet kryesore:

- është nënshkruar **Memorandum bashkëpunimi** ndërmjet MMPHI dhe Komunës së Dragashit,
- është ofruar mbështetje koordinuese për projektin e **banimit social**,
- janë përgatitur aktivitetet për:
- ndërtimin e banesave sociale adekuate,
- renovimin dhe rindërtimin e shtëpive private.

## 7. Vlerësimi i përgjithshëm i sektorit

Bazuar në aktivitetet e realizuara, konstatohet se **Spektori i Mbrojtjes së Mjedisit** gjatë vitit 2025:

- ka vepruar në përputhje me kompetencat ligjore,
- ka siguruar monitorim të vazhdueshëm mjedisor,
- ka koordinuar me sukses me institucionet qendrore,
- ka arritur një nivel të lartë të efikasitetit institucional.

## VI. SHËRBIMI PËR ÇËSHTJET PRONËSORE DHE LIGJORE

Shërbimi për çështjet pronësore dhe ligjore i **Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtjen e Mjedisit** gjatë vitit **2025** ka kryer detyrat në përputhje me legjislacionin në fuqi, **Planin e Punës për vitin 2025** dhe Urdhrin e drejtorit nr. 06-052/01-2650/26 të datës 09.02.2026.

Punonjësit kanë fokusuar aktivitetet e tyre në:

- zgjidhjen e çështjeve pronësore dhe ligjore,
- trajtimin e lëndëve për uzurpim dhe eksproprijim,
- përfaqësimin e komunës para gjykatave,
- administrimin e pronës komunale.

### 1. Lëndët për uzurpimin e pronës komunale

Gjatë vitit **2025** janë evidentuar:

- **Gjithsej lëndë uzurpimi:** 9–10 (sipas raporteve të veçanta)
- **Të përfunduara me vendim:** 2
- **Në procedurë:** shumica e lëndëve (procedurë administrative)

Aktivitetet kanë përfshirë:

- pranimin dhe shqyrtimin e ankesave,
- vizita në terren me gjeodetë dhe inspektorët,
- mbledhjen e provave,
- zhvillimin e procedurave administrative.

Në disa lëndë është konstatuar se nuk ka elemente uzurpimi, ndërsa lëndët e tjera janë në faza të ndryshme të procedurës.

## 2. Zgjidhja e marrëdhënieve pronësore në investimet publike

Gjatë periudhës raportuese:

- është kryer 1 procedurë ndarja e parcelës lidhur me një investim publik,
- janë zhvilluar procedura për dhënie e pronës komunale për përdorim,
- lënda NIKI-999 është në procedurë preliminare (verifikim i kompetencës dhe pengesave ligjore).

## 3. Procedurat e shpronësimit

Gjatë vitit 2025:

- është në proces 1 procedurë shpronësimi (Brezna – impiant për ujërat e ndotura),
- është marrë vendim për shqyrtimin e mëtejshëm të iniciativës,
- lënda është dërguar në institucionet kompetente për vlerësimin e pasurisë.

## 4. Pjesëmarrja në komisione

Punonjësit e **Shërbimit për Çështjet Pronësore dhe Ligjore** kanë marrë pjesë aktivisht në punën e disa komisioneve, duke përfshirë:

### Komisioni për korrigjimin e gabimeve në regjistrin kadastral

- kërkesa të pranuar: 90
- të gjitha lëndët janë zgjidhur
- janë marrë vendime përkatëse

### Komisioni për shitjen e banesave

- në punë: 5 lëndë
- pezullim për shkak të dokumentacionit të paplotë të palëve

- nevoja për formimin e një komisioni të ri për shkak të ndryshimeve në staf

### **Komisione të tjera**

- komisioni për vendbanime të përkohshme
- komisioni për dhënien e pronës komunale për përdorim deri në një vit
- ofrimi i ndihmës profesionale për shërbime të tjera

## **5. Përfaqësimi i Komunës para gjykatave**

Gjatë vitit **2025**, shërbimi ka pasur një volum të konsiderueshëm të lëndëve gjyqësore:

- janë shqyrtuar rreth 200 padish (kryesisht nga fusha e arsimit),
- janë dërguar mbi 200 përgjigje ndaj padive,
- përfaqësim aktiv në rreth 30 lëndë gjyqësore,
- disa lëndë zhvillohen para:
  - Gjykatës Themelore
  - Gjykatës Ekonomike
  - Gjykatës Administrative
  - Gjykatës së Lartë

Lënda më e vjetër aktive daton nga **1992**.

## **6. Ndihma ligjore dhe aktivitetet këshilluese**

Gjatë vitit, punonjësit kanë:

- ofruar këshilla ligjore për palët,
- ndihmuar në çështje pronësore dhe ligjore,
- kryer arkivimin dhe administrimin e kontratave,
- përditësuar regjistrat e pronës komunale,
- përgatitur draft-vendime dhe kontrata.

Fokus i veçantë ka qenë në:

- menaxhimin e pronës komunale,
- sigurinë ligjore të procedurave,
- mbështetjen e sektorëve të tjerë të Drejtorisë.

## **7. Vlerësimi i përgjithshëm i punës**

Bazuar në raportet individuale të dorëzuara, mund të konkludohet se **Shërbimi për Çështjet Pronësore dhe Ligjore** gjatë vitit **2025**:

- ka vepruar në përputhje me ligjin,
- ka përpunuar një numër të konsiderueshëm lëndësh komplekse,
- ka siguruar përfaqësimin e interesave të Komunës para gjykatave,
- ka marrë pjesë aktivisht në menaxhimin e pronës komunale,
- ka ofruar mbështetje ligjore për projektet kapitale.



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
REPUBLIC OF KOSOVO



Kuvendi Komunal Dragash – Skupština Opštine Dragaš – Municipality of Dragash  
Drejtoria për Bujqësi, Inspeksion, Turizëm, Pylltari dhe Zhvillim Rural  
Direktorijata za Poljoprivredu, Inspekciju, Turizam, Šumarstvo i Ruralni Razvoj  
Directorate for Agriculture, Inspections, Tourism, Forestry and Rural Development

DATA/DATUM:	26/02/2026
REFERENCE-E:	09/Br.
PËR/ZA/TO:	Zyrës së Kryetarit të Komunës së Dragashit
CC:	
PERMES/PREKO/THROUGH:	Shërbimi për përkthim i Kuvendit
NGA/OD/FROM:	Drejtoria për Bujqësi, Inspeksion, Pylltari, Turizëm dhe Zhvillim Rural Drejtore: Enes Goran
TEMA/SUBJEKT/SUBJECT:	RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2025

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2025

Në bazë të dispozitave ligjore në fuqi për rolin dhe kompetencat e Drejtorisë, bazuar në objektivat e Planit të Punës për vitin 2025, aktivitetet në bazë të punës së Drejtorisë përkatëse gjatë vitit 2025 u zhvilluan si më poshtë.

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
Komuna e Dragashit  
Opština Dragaš

02 Nr. Br. 052/09-3609/26  
26-02-2026  
Dragash - Dragaš

## SEKTORI PËR BUJQËSI, TURIZËM DHE ZHVILLIM RURAL

Sektori për Bujqësi dhe Zhvillim Rural ne Komunën e Dragashit gjatë vitit 2025 ka zbatuar projekte dhe iniciativa të rëndësishme për zhvillimin e bujqësisë dhe zonave rurale. Aktivitetet e zhvilluara janë orientuar drejt mbështetjes së fermerëve, zhvillimit të qëndrueshëm rural, përmirësimit të infrastrukturës dhe fuqizimit të sektorëve ekonomikë që lidhen me bujqësinë dhe mjedisin rural

### **Bashkëpunimi me MBPZHR:**

Duke pasur parasysh se politikat bujqësore shtetërore hartohen nga Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtorati për Bujqësi, Inspektion, Turizëm, Pylltari dhe Zhvillim Rural, përmes Sektorit për Bujqësi dhe zhvillim rural, në bashkëpunim të plotë me MBPZHR dhe zyrën regjionale të MBPZHR në Prizren kemi shkëmbyer të dhëna statistikore-përpunimi i tyre dhe raportimin lidhur me implementimin dhe realizimin e projekteve ne këtë sektor.

Po ashtu kemi mbështetur dhe realizuar në plotni implementimin e Programit për pagesa direkte 2025 për t'u siguruar fermerëve rrugën më të shkurtër të shërbimeve dhe mbështetje në realizimin e mjeteve të pagesave direkte për bujqësi (subvencioneve), si dhe aplikim në Grante për zhvillimin e bujqësisë.

### **Programi i pagesave direkte i MBPZHR për vitin 2025-**

Janë realizuar subvencione për **338 fermerë** aktiv sipas kriterëve të parapara në këto lëmi:

- Prodhimtari blegtorale (lopë mjelëse, viça për majmëri, mështjerra për mbarëshitim, dele mjelëse, dhi mjelëse, pula vojse, zogj për mish etj),
- Bletari,
- Pemëtari (për sipërfaqe të mbjella dhe dhe për rendiment)
- Perimtari (për sipërfaqe të mbjella dhe dhe për rendiment)
- Pagesa direkte për mbjelljen e kulturave bujqësore lavërtarë (për sipërfaqe të mbjella dhe për rendiment), si dhe
- Cilësi të qumështit të shitur në qumështore dhe pika grumbulluese të licencuara (aplikimi çdo 6 muaj).

**Programi për Zhvillim Rural i MBPZHR:** Programi i garantëve për vitin 2024 është hapur me 27.12.2024 dhe ka vazhduar deri në fund të muajit janar 2025. Në gjatë kohës së aplikimit kemi mbështetur rreth 30 fermerët me informata rreth kriterëve shërbime këshillimore dhe përmirësim të të dhënave në regjistër të fermerëve. Si rezultat kemi 7 fermer përfitues të garantëve të MBPZHR.

Për vitin 2025 nuk ka patur thirrje të hapur për aplikim në grante të MBPZHR.

### **Njoftimi-informimi i fermerëve lidhur me pjesëmarrjen në thirrje për aplikime:**

Mbështetje në këshillime dhe dhënje të informatave për fermerë në kompletimin e dokumentacionit të caktuar për aplikim ( rreth 500 fermer janë informuar për kriteret e aplikimit në programin e pagesave direkte-subvencione dhe rreth 20 fermer, agropërpunues e biznes rurale) rreth kriterëve në aplikim për grante zhvillimore.

**Bashkëpunimi me Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë-AZHB Prishtinë dhe zyrën rajonale në Prizren:** Shkëmbimi i informatave në mbështetje të fermerëve në realizim të

projekteve për Pagesa direkte Subvencione (lopë qumështore, dele, dhi, bletë, kultura bujqësore etj), organizimi i trajnimeve rreth aplikimit në Grante.

**Këshilla për fermerë dhe grupe të fermerëve:** Organizimi i trajnimeve për fermerët në prodhimtarinë blegtorale mbështetet nga MBPZHR konkretisht sektori i Shërbimit këshillimor. Aktivitetet bëhen në teren si dhe në hapësirat e sektorit.

**Përgjigjeje ndaj kërkesave të fermerëve:** Pranimi, përpunimi dhe përgjigjeje ndaj kërkesave të fermerëve (gjatë tërë vitit).

**Bashkëpunimi me CARTIAS-in Zvicëran:** Vazhdimi i bashkëpunimit në projekte implementuese në fushën e bujqësisë e agropërpunimit;

**Bashkëpunimi me IADK-në:** Vazhdimi i bashkëpunimit në projekte implementuese në fushën e bujqësisë e agropërpunimit;

**Bashkëpunimi me Shoqatën Mjedrat e Kosovës :** Vazhdimi i bashkëpunimit në projekte implementuese në fushën e bujqësisë e agropërpunimit;

**Bashkëpunimi me OJO-të që veprojnë në komunën e Dragashit:** bashkëpunimi në projekte në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural (trajnime, takime me interes nga lëmi e bujqësisë).

**Bashkëpunimi me qumështoret dhe pikat për grumbullimi dhe përpunimin e qumështit:** Qëllimi i arritjes së synimeve për ngritje të kapaciteteve grumbulluese dhe ngritje të cilësisë së qumështit dhe produkteve të tije. Po ashtu edhe ngritja e cilësisë së qumështit nga ana e fermerëve si dhe arritja e synimeve në realizimin e subvencioneve për cilësi të qumështi në MBPZHR.

**Bashkëpunimi me Pikat grumbulluese të Bimëve mjekuese dhe frutave malore-** Bashkëpunim permanent rreth zgjidhjes së problemeve të këtij sektori dhe gjetjen e mundësive për mbështetje të vazhdueshme me subvencione dhe grante zhvillimore në rritjen e kapaciteteve prodhuese për pemë të imta dhe përmirësim të infrastrukturës përcjellëse.

**Vizitat e fermerëve në ferma dhe në pikat sezonale verore:**

Kemi realizuar disa vizita në teren, problemet mbetën të njëjta, mbështetja nga autoritet shtetërore e nevojshme në përmirësimin e kushteve sanitare dhe higjienike në prodhimtari si dhe në mbarështim dhe kultivim të kafshëve. Kërkesa e tyre të arsyeshme në mbështetje me subvencione dhe grante në zhvillim të mëtutjeshëm.

**Takimet dhe aktivitetet me bletarët:** Regjistrimi i bletarëve, mbajtja e shënimeve të këtij sektori. Nevojë e përhershme mbështetja me trajnime e këshilla profesionale si dhe mbështetje me subvencione dhe grante në përmirësim të kushteve të punës në nxjerrje të mjaltit, preventiva dhe trajtimi me preparate në mbrojtjeje nga sëmundjet.

**Bashkëpunimi dhe mbikëqyrja e të mbiellurave pranverore dhe vjeshtore:** Prill-Maj, Shtator-Tetor. Mbjellja ishte planifikuar në sipërfaqe rreth 150 Ha, janë realizuar në sipërfaqe rreth 94 Ha.

**Organizimi dhe përcjellja e korrjeve-shirjeve:** Korrik-Shtator. Korrja u krye në afat të paraparë pa ndonjë problem të evidentuar me një rendiment nën mesataren e planifikuar për regjionin tonë (për shkak të kushteve klimatike-thatësisë).

**Realizimi i Thirrjes Publike-Subvencionimi i ushqimëve për kafshë 2025:** Ky projekt është realizuar përmes thirrjes publike ku janë publikuar kushtet dhe kriteret për aplikim. Në bazë të thirrjes publike kanë aplikuar gjithsej 248 aplikues fermerë dhe nga ta janë të gjithë të kompletuar me dokumentacione ku gjithsej janë 257 përfitues në vlerë 89477 Euro (tetëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë euro).

Kjo thirrje publike është planifikuar, implementuar e financuar nga buxheti i komunës në vlerë totale 87148 € për subvencione në:

	Lopë mjelëse	Dele mjelëse	Dhi mjelëse	Shoqëri Bletësh	Fëllënza vojse	Pula vojse
Numri krerëve	1637	9900	89	3203	550	7500
Vlera për krerë/€	30	3	3	2	0.3	0.2
Gjithsejtë Euro	49110	29700	267	6406	165	1500
<b>Gjithsejtë Euro</b>						<b>87148</b>

**Vërejtje:**

Për shkak të mungesës së buxhetit, pagesat për fermerët përfitues nuk kanë mundur të realizohen gjatë vitit 2025. Andaj, ato pritet të realizohen gjatë tremujorit të parë të vitit 2026.

**Realizimi i projektit Organizimi i Panairit me produkte vendore lokale:** Edhe këtë vit si vitin e kaluar është organizuar Panairi tradicional me produkte lokale vendore.

**Qëllimi** i organizimit të këtij panairi është prezantimi i prodhimeve bujqësore-blegtorale dhe artizanale, prezantimi i produkteve vendore-lokale të rajonit tonë, në mënyrë që qytetarët të njihen me këto prodhime dhe më cilësinë e tyre, t'u ofrohet mundësia bizneseve lokale-vendore të promovojnë produktet e tyre në mënyrë që të rrisin pjesëmarrjen e tyre në treg si dhe të bëjë që konsumatorët të njihen me produktet e reja dhe ato ekzistuese.

Ky projekt është realizuar përmes thirrjes publike ku përfitues për implementim ka qenë Shoqata Afaristëve Sharri Dragash, Vlera totale e projektit ka qenë 13000 Euro, është financuar nga buxheti i komunës dhe mbikëqyrur nga sektori për bujqësi dhe zhvillim rural. Është realizuar gjatë muajit Shtator 2025 ( e Premte 26.09.2025).

**Realizimi i projektit Vaksinimi i qenve me pronar kundër sëmundjes së Tërbimit:** gjatë tre muajorit të fundit të vitit 2025 është realizuar Vaksinimi i qenve me pronar kundër Tërbimit dhe dehelmetizimit të tyre në territorin e Komunës së Dragashit.

**Qëllimi** i realizimit të këtij projekti ka qenë Parandalimi i përhapjes së kësaj sëmundjeje dhe për të mbrojtur shëndetin e qenve dhe njerëzve.

Ky projekt është realizuar përmes tenderimit ku janë vaksinuar 1000 qen me pronar me vlerë totale 4499 Euro. Është financuar nga buxheti i komunës dhe mbikëqyrur nga sektori për bujqësi dhe zhvillim rural.

**Bashkëpunimi me Grupin Lokal te Veprimit Bio Sharri** – Monitorimi dhe Implementimi i projektit te GLV Bio Sharri: Përgatitja dhe zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal – qasja LEADER, mbështetur nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe implementuar nga GLV Bio Sharri Dragash.

## SEKTORI PËR INSPEKSION

Monitorimi dhe kontrolli i aktiviteteve

- Inspektorët e tregut, ndërtimit dhe komunal realizuan kontrole në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi.
- Inspektime të rregullta në fushat e tregut, ndërtimit dhe shërbimeve komunale.
- Verifikim i kushteve sanitare dhe higjienike në objektet.

Parandalimi dhe zgjidhja e shkeljeve

- Identifikimi i parregullsive në shfrytëzimin e burimeve natyrore dhe fondeve publike.
  - Marrja e masave ligjore kundër shkelësve dhe nxitja e përputhshmërisë me rregulloret.
- Bashkëpunimi me institucionet dhe komunitetin
- Shkëmbim i të dhënave me institucionet inspektuese dhe të sigurisë.
  - Informim dhe edukim i qytetarëve për zbatimin korrekt të rregulloreve.

Rezultatet Kryesore

- Përmirësim i përputhshmërisë me ligjet në sektorët kryesorë.
- Reduktim i parregullsive dhe keqpërdorimeve në shfrytëzimin e burimeve.
- Fuqizim i bashkëpunimit institucional për inspektime më efikase.





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
Komuna Dragash – Opština Dragaš – Municipality of Dragash  
Drejtoriai për shëndetësi dhe mirëqenies sociale  
Direktorijati za zdravstvo i socijalno staranje



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
Komuna e Dragashit  
Opština Dragaš

02 Nr. Br. 052/01-3576/26  
26.02.2026  
Dragash - Dragaš

Raporti i punës i Drejtoratit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për periudhën

Janar – Dhjetor 2025

Drejtor

Behar Brenoli

Dragash: Janar 2026

Në bazë të Statutit të Komunës së Dragashit, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale është përgjegjëse për:

- Sigurimin e kujdesit shëndetësor primar në komunën e Dragashit, në pajtim me rregullat ligjore.
- Inspektimi i qendrave private për kujdesin shëndetësor primar.
- Vlerësimi i nevojave për mbrojtje primare.
- Ngritja e objekteve lokale për kujdesin shëndetësor primar.
- Zhvillimi i buxhetit në bazë të nevojave lokale, duke ndjekur udhëzimet e Ministrisë së Shëndetësisë
- Koordinon dhe mbikëqyr punën e QKMF, QMF dhe AMF-së.
- Veprimi i Qendrës për Punë Sociale dhe Mirëqenie Sociale.
- Zhvillimi i një plani akomodimi për territorin e komunës.
- Siguron ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare brenda territorit, sipas standardeve të vendosura nga MPMS dhe
- Punë të tjera të përcaktuara nga Kryetari i Komunës.

*DSHMS – Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Social*

*QKMF – Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare*

*QMF – Qendra e Mjekësisë Familjare*

*AMF – Ambulanca e Mjekësisë Familjare*

*QPS – Qendra për Punë Sociale*

*MSH – Ministria e Shëndetësisë*

*MPMS – Ministria e Punës dhe Mbrojtjes Sociale*

## **SEKTORI I SHËNDETËSISË**

### **QËLLIMET E PËRGJITHSHME**

*Ofrimi i kujdesit shëndetësor primar për popullatën e komunës së Dragashit, përmes zbatimit të konceptit të mjekësisë familjare në sistemin unik të shëndetësisë të Republikës së Kosovës.*

- Shërbimet shëndetësore për zhvillimin, parandalimin, trajtimin, shërimin dhe rehabilitimin e sëmundjeve, çrregullimeve dhe lëndimeve.
- Edukimi shëndetësor dhe parandalimi, imunizimi dhe vaksinimi.
- Përcaktimi i diagnozës fillestare dhe kujdesin esencial shëndetësor, kujdesin akut, duke përfshirë kujdesin emergjent, stabilizimin dhe transportin në institucionet përkatëse, kujdesin e sëmundjeve kronike dhe intervenime kirurgjike të vogla.
- Kujdesi në shtëpi përmes vizitave të populates.
- Personeli shëndetësor dhe edukimi i popullsisë, imunizimi dhe vaksinimi.
- Përcaktimi i diagnozës fillestare dhe kujdesit bazë shëndetësor, duke përfshirë edhe intervenimet e vogla kirurgjikale.
- Promovimi i shëndetit oral, i cili e parandalon kariesin e dhëmbëve si kujdesin themelor dentar.
- Sigurimi i shërbimeve shëndetësore diagnostike - analiza laboratorike dhe të rentgenit në kuadër të kujdesit shëndetësor primar.
- Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i personelit shëndetësor dhe jo mjekësor
- Menaxhimi dhe shpërndarja e barnave nga lista esenciale
- Të afrohen shërbimet më afër popullatës.

## **ORGANIZIMI I PUNËS**

Struktura organizative e QKMF-së bazohet në Statutin e QKMF-së, Ligji për shëndetësi, UA që është në fuqi dhe përbëhet nga departamentet, sektorët dhe njësitë, si vijon:

I - Departamenti i Mjekësisë Familjare, me sektorë dhe njësi:

1. Sektori i mjekësisë familjare
2. Sektori diagnostikues
  - a) Njësia laboratorike
  - b) Njësia e rendgenit (rtg digjitale, UZ)
3. Sektori i Shëndetit Publik
  - a) Njësia e vaksinimit dhe e imunizimit.
4. Njësia e Sistemit Informativ Shëndetësor.
5. Sektori konsultativ
6. Sektori Emergjent

II. Departamenti i Administratës:

III. Departamenti i Stomatologjisë

IV. Farmacia Qendrore - brenda QKMF-së, e cila shpërndan barna nga lista esenciale e barnave në të gjitha QMF-të dhe AMF-të.

## **INSTITUCIONET SHËNDETËSORE NË KOMUNËN E DRAGASHIT**

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare ( 1 )

Qendra e Mjekësisë Familjare ( 5 )

Ambulanca të Mjekësisë Familjare ( 8 )

Shërbimi i kujdestarisë ( 1 )

## **BURIMET NJERËZORE DHE STATISTIKA E PUNËTORËVE**

Deri në fund të vitit 2025, numri i të punësuarve në sektorin shëndetësor është 117. Mjekët e mjekësisë familjare -18, stomatolog - 8, staf ndihmës -11, motra med. / teknik -72, administrata -2, shoferë -6. QKMF-ja aktivitetin e saj e ka fokusuar në ofrimin e shërbimeve shëndetësore cilësore të bazuara në konceptin e mjekësisë familjare.

Të sigurohen pajisje, barna dhe materiale sanitare më cilësore.

Planifikimi dhe dinamika e ofrimit të shërbimeve, bazuar në mundësitë e disponueshme të burimeve njerëzore, numrin e institucioneve shëndetësore dhe kapacitetet buxhetore.

Përmirësimi i sistemit të informacionit shëndetësor.

Bashkëpunimi me të gjitha organizatat, si dhe me organizatat qeveritare dhe joqeveritare siç janë: TIKA, CIMIK (KFOR), MSH, AHQ, AMC, AKK, WHO, UNICEF, Banka Botërore, etj.

## ARRITJET

- Rritja e kapaciteteve njerëzore, personelit mjekësor, mjekëve/infermierëve.
- Dyfishimi i stafit të urgjencës për të rritur cilësinë dhe efikasitetin e punës.
- Zhvillimi dhe edukimi i vazhdueshëm profesional i punëtorve të kujdesit shëndetësor
- Ofrimi i shërbimeve për pacientët pa participim.
- Modernizimi i pajisjeve shëndetësore dhe shtimi i shërbimeve.
- Furnizimi me materiale laboratorike dhe reagentë.
- Furnizimi i kondicionerëve dhe kompjuterëve për QKMF, QMF dhe AMF.
- Inventari dhe pajisje të tjera iu dorëzuan institucioneve shëndetësore me qëllim modernizimin dhe rritjen e shërbimeve.
- Furnizimi me barna për nevojat e institucioneve shëndetësore dhe për menaxhim dhe trajtim më të mirë të rasteve në emergjencë.
- Zbatimi i ligjeve në fuqi, Ligjit për Shëndetësi, Ligjit të Punës, akteve nënligjore dhe UA.
- Përmirësimi i statusit të imunizimit dhe vaksinimit në komunën e Dragashit.
- Vaksinimi 100% me vaksinën e re kundër HPV.
- Është hapur objekti i ri i QMF-së në Krushevë, i cili i plotëson standardet më të larta të parashikuara për këtë lloj institucioni shëndetësor.
- Janë realizuar kontrole sistematike të nxënësve në 30 shkolla, gjatë të cilave janë kryer kontrolli i përgjithshëm shëndetësor si dhe kontrolli stomatologjik.

Edhe gjatë këtij viti janë ofruar shërbime specialistike falas për qytetarët e Komunës sonë, ku në bashkëpunim me OJQ-në Human Care kemi ofruar shërbime falas të Gjinekologut, Oftalmologut, Neuropsikiatrit dhe Internist-Kardiologut. Gjatë këtij angazhimi, numri i mëposhtëm i qytetarëve tanë ka marrë shërbime dhe këshilla të specializuara:

- Oftalmolog – 572
- Gjinekolog - 1190
- Neuropsikiatër – 402
- Internist-kardiolog – 756

- Në bashkëpunim me zyrën e UNMIK-ut, përmes OJQ-së Advanced Together, kemi zbatuar dy projekte nga memorandumit që komuna ka nënshkruar me UNMIK-un. Projekti i parë ka të bëjë me ofrimin e shërbimeve stomatologjike për personat e palëvizshëm si dhe për fëmijët. Kemi renovuar dhe pajisur plotësisht ordinancën stomatologjike në katin e parë në repartin e Pediatriisë, e cila ka qasje për karroca për invalid, në mënyrë që shërbimet stomatologjike t'u ofrohen edhe kësaj kategorie pacientësh, për të cilët deri më tani kjo nuk ka qenë e mundur për shkak të mungesës së qasjes (stomatologjia është në katin e fundit të QKMF-së dhe nuk ka ashensor). Në kuadër të projektit të dytë kemi siguruar PAP TEST falas për të gjitha gratë e komunës sonë që kanë nevojë për të. Gjatë vitit 2025 janë realizuar 280 testime.

• Kemi organizuar aktivitete të ndryshme për shënimin e ditëve të rëndësishme për shëndetin e qytetarëve, ndër të tjera edhe “Muaji Rozë”, si dhe disa ligjërata për ngritjen e vetëdijes mbi sëmundjet kronike (astma, diabeti, hipertensioni etj.), si dhe aksionin e dhurimit vullnetar të gjakut në QKMF, etj.

Në bashkëpunim me OJQ-në Syri Vision kemi marrë pjesë në “Karavanin Shëndetësor”, gjatë të cilit qytetarëve u janë kryer kontrole shëndetësore si dhe janë dhënë këshilla për ruajtjen e shëndetit.

Ekipe të QKMF-së kanë marrë pjesë në projektin “Drejt Malit”, të cilin çdo vit e organizon Federata e Sportit Shkollor të Kosovës në Brezovicë, gjatë të cilit kanë ofruar shërbime si për fëmijët pjesëmarrës në kamp ashtu edhe për shumë qytetarë që kanë qëndruar në qendrën e skijimit.

Ekipe tona mjekësore kanë ofruar asistencë në të gjitha aktivitetet sportive dhe kulturore në komunën tonë, si dhe gjatë garave të futbollit të klubeve tona.

Kemi realizuar vizita në institucione me qëllim të mbikëqyrjes së aktiviteteve dhe eliminimit të mangësive.

Është me rëndësi të theksohet se numri i shërbimeve që kemi ofruar në Diagnostikë/Laborator, i paraqitur në tabelë, bazohet në regjistër dhe i korrespondon një pacienti; ndërsa duke marrë parasysh analizat individuale që kryhen për një pacient, mund të realizohen deri në 5 shërbime me mbi 25 analiza për pacient.

Në sektorin e Mjekësisë Familjare, gjatë vitit 2025, janë regjistruar gjithsej 89223 vizita të pacientëve dhe janë ofruar 112648 shërbime për pacientët.

NR.	Institucioni	Departamenti	2025	
			Vizita	Shërbimet
1	QKMF Dragash	Mjekësi e Përgjithshme / Gjinekologjija	1100	1282
		Mjekësi e Përgjithshme / Laboratori	5000	5888
		Mjekësi e Përgjithshme / Radiologjija	1518	3159
		Mjekësi e Përgjithshme / Shërbimi Emergjent	33855	39866
		Mjekësi e Përgjithshme / Stomatologjija	1900	2888
		Mjekësi e Përgjithshme	13369	21596
		Vaksinimi	1800	2140
		Mjekësi e Përgjithshme / Ultrazëri	540	540
		Gjithsej	59082	77359
2	QMF Brodosanë	Mjekësi e Përgjithshme	11201	12969
		Mjekësi e Përgjithshme / Laboratori	3152	3152
		Mjekësi e Përgjithshme / Stomatologjija	756	1671
		Gjithsej	15109	17792
3	QMF Llopushnik	Mjekësi e Përgjithshme	2324	4215
4	QMF Bellobrad	Mjekësi e Përgjithshme	1257	1788

		Mjekësi e Përgjithshme / Laboratori	65	100
		Gjithsej	1322	1888
5	QMF Krushevë	Mjekësi e Përgjithshme	5885	2338
		Mjekësi e Përgjithshme / Laboratori	2761	2761
		Mjekësi e Përgjithshme / Stomatologjia	175	175
		Gjithsej	8821	5274
6	QMF RAPÇË	Mjekësi e Përgjithshme	393	833
7	AMF RESTELICA	Mjekësi e Përgjithshme	150	600
8	AMF BROD	Mjekësi e Përgjithshme	447	447
9	AMF RADESHË	Mjekësi e Përgjithshme	617	653
10	AMF KUK	Mjekësi e Përgjithshme	488	620
11	AMF KOSAVË	Mjekësi e Përgjithshme	0	1158
12	AMF BLAÇ	Mjekësi e Përgjithshme	307	920
13	AMF VRANIÇË	Mjekësi e Përgjithshme	163	430
14	AMF GLLOBOÇIÇË	Mjekësi e Përgjithshme	0	459
		Gjithsej	89223	112648

## INVESTIMET KAPITALE

Gjatë vitit 2025 janë realizuar projektet si në vijim:

1. Renovimi i QMF-së në Rapçë dhe AMF-ve në Restelicë, Brod, Radeshë, Vraniçë, Glloboçicë.
2. Renovimi i QKMF-së në Dragash (ndër të tjera sporteli dhe këshillimorja).

## VËSHIRËSITË DHE SFIDAT

Është e nevojshme që të vazhdohet me renovimin e objekteve shëndetësore që i kemi rinovuar këtë vit, si të tjerat në rajonin e Gorës, si dhe vetë QKMF-në në Dragash.

Kufizimet ligjore në bazë të popullsisë.

Mungesa e stafit, veçanërisht mjekët në komunitetin jo-shumicë.

Furnizimi i pamjaftueshëm me barna nga Farmacia Qendrore pranë Ministrisë së Shëndetësisë

## SEKTORI PËR MIRËQENIE SOCIALE

Raporti për periudhën Janar-Dhjetor 2025 përfshin punën e Sektorit të Shërbimeve Sociale Profesionale, Sektorit të Shërbimeve të Ndhmës Sociale dhe Sektorit të Shërbimeve Administrative-Financiare. Gjatë kësaj periudhe vjetore u mbuluan detyrat bazë të QPS-së, të cilat u zbatuan në bazë të dispozitave ligjore në fuqi.

Udhëheqësi, zyrtarët e shërbimit social, si dhe në shumicën e rasteve drejtori i QPS-së, problemeve të paraqitura i janë qasur me përkushtim profesional, shumica e rasteve të paraqitura janë zgjidhur me sukses. Gjatë vitit kalendarik 2025, shërbimet e QPS-së janë angazhuar kryesisht në këto kategori:

<b>I. Fëmijët pa kujdes prindëror</b>	<b>2025</b>	<b>Gjithsej</b>
a) Fëmijë pa përkujdesje prindërore	0	48
b) Fëmijë në strehim familjar me pagesë	0	36
c) Fëmijë të braktisur	0	14
d) Fëmijë prindërit e të cilëve nuk përmbushin detyrën prindërore	5	12
<b>II. Fëmijët në familjet me konflikte</b>	<b>2025</b>	<b>Gjithsej</b>
a) Abuzimi dhe neglizhimi	5	38
b) Fëmijët në familjet me marrdhënie të pa rregulluar	22	189
c) Fëmijët e prindërve të divorcuar	16	126
<b>III. Fëmijët dhe të rinjtë me sjellje të papërshtatshme</b>	<b>2025</b>	<b>Gjithsej</b>
a) Fëmijët me sjellje asociale	0	115
b) Delikventë të mitur prej 14-16	12	94
c) Delikventë të mitur prej 16-18	12	126
d) Fëmijët që merren me punë të rrezikshme	0	0
<b>IV. Fëmijët dhe të rinjtë me nevoja të veçanta</b>	<b>2025</b>	<b>Gjithsej</b>
a) Psiqike	2	56
b) Fizike	1	50
c) Të kombinuara	0	83
<b>V. Persona viktima të trafikimit të njerëzve</b>	<b>2025</b>	<b>Gjithsej</b>
a) Fëmijë	0	0
b) Të rritur	0	0
<b>VI. Të rriturit me nevoja të veçanta</b>	<b>2025</b>	<b>Gjithsej</b>
a) Psiqike	9	238
b) Fizike	2	231
c) Të kombinuar	0	72
<b>VII. Të rriturit në gjendje konfliktuoze</b>	<b>2025</b>	<b>Gjithsej</b>
a) Të rriturit me marrdhënie familjare të pa rregulluar	35	305

b)	Dhunë në familje	17	191
c)	Personat në proces të divorci Personat që kanë ndërprerë bashkimin	6	245
d)	jashtëmartesor	2	19
<b>VIII.</b>	<b>Të rriturit me sjellje asociale</b>	<b>2025</b>	<b>Gjithsej</b>
a)	Të pastrehë	0	14
<b>IX.</b>	<b>Të moshuarit në gjendje nevojë sociale</b>	<b>2025</b>	<b>Gjithsej</b>
a)	Të moshuarit pa kujdes familjar	35	193
b)	Të moshuarit me nevoja të veçanta	4	38
<b>X.</b>	<b>Personat që kanë tentuar të bëjnë vetëvrasje</b>	<b>2025</b>	<b>Gjithsej</b>
a)	Të rriturit	0	6
b)	Fëmijët	0	3

Në këto dhe raste të tjera, shërbimi profesional e mori seriozisht dhe u përpoq ta tregonte atë në mënyrën më profesionale. Me të gjitha kategoritë me të cilat është ballafaquar Shërbimi Profesional QPS në Dragash, janë implementuar forma të ndryshme të mbrojtjes sociale.

	2025	Gjithsej
1. Fëmijë të adoptuar	0	31
2. Kujdestari	0	41
3. Strehim familjar	0	17
4. Strehim në shtëpi të sigurtë	1	13
5. Strehim banesor	4	4
6. Trajtimi i rasteve dhe risocializimi	17	306
7. Kujdesi për të rriturit	2	18
8. Kërkesat për martesë të hershme	2	78
9. Banorët e vendosur në shtëpi të pleqve	0	5

### **Izveštaj o procesu prijave za socijalno stanovanje – renoviranje i izgradnja privatnih kuća**

Në kuadër të projektit “Strehim social adekuat”, i zbatuar nga Komuna e Dragashit në përputhje me marrëveshjen e bashkëpunimit me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, është shpallur thirrja publike për aplikim në nën-projektin “renovimi – ndërtimi i shtëpive private për familjet në nevojë”.

Thirrja publike është shpallur më **08.08.2025**.

Afati fillestar për aplikim ishte **20.08.2025**, i cili më pas është shtyrë për t’u dhënë mundësi aplikimi një numri më të madh qytetarësh deri më **10.09.2025**.

Gjatë kësaj periudhe kanë aplikuar gjithsej 76 familje, prej të cilave: 41 familje (26 shqiptare dhe 15 gorane/boshnjake, nga të cilat 9 aplikante ishin gra) kanë aplikuar për renovimin e shtëpive 2 familje (1 shqiptare dhe 1 gorane/boshnjake) kanë aplikuar për ndërtimin e shtëpive, ndërsa 33 familje janë refuzuar për shkak të mungesës së dokumentacionit ose mosplotësimin të kushteve të thirrjes.

Procesi i aplikimit për strehim social dhe ndërtimin e shtëpive është zhvilluar në përputhje me afatin e zgjatur, me qëllim rritjen e përfshirjes së familjeve që kanë nevojë për këtë mbështetje. Numri i konsiderueshëm i aplikimeve tregon interes të madh të qytetarëve për përmirësimin e kushteve të banimit, ndërsa një numër i konsiderueshëm aplikimesh është refuzuar për shkak të mungesës së dokumentacionit të nevojshëm.

Procesi për familjet që janë kualifikuar (41 familje për renovim dhe 2 familje për ndërtim) është në vazhdim. Shërbimi i ministrisë përkatëse ka kërkuar dokumentacion shtesë brenda një afati prej 60 ditësh, me qëllim verifikimin dhe plotësimin e dosjeve, në mënyrë që të vazhdohet me fazat e ardhshme të realizimit të këtij projekti.

## **BASHKËPUNIMI DHE ARRITJET**

DSHMS si dhe Shërbimi Profesional i QPS-së ka bashkëpunim shumë të mirë me Departamentin e Politikës Sociale dhe Familjes – në veçanti me Departamentin e shërbimeve sociale, me ministrinë e drjetësis pasi që punojmë dhe veprojmë sipas udhëzimeve të tyre. Ne gjithashtu kemi bashkëpunim të mirë me Departamentin e Politikave Sociale, me QPS-të në nivel rajonal dhe në nivel të Kosovës. Kemi bashkëpunim shumë të mirë me vetëqeverisjen lokale, drejtoritë komunale në përgjithësi. Kemi pasur bashkëpunim shumë të suksesshëm me Policinë, Gjykatën Themelore, Qendrën e Shëndetit Mendor të Komunitetit në Prizren, me OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare, kemi bashkëpunim me sindromën Down Kosova në Prizren për trajtimin e fëmijëve të kësaj kategorie si dhe këshillimin e familjarëve të tyre.

Gjatë këtij viti, Shërbimi i Ndhmës Sociale ka zbatuar rreptësisht Ligjin nr. 04/L-096 mbi ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për skemën e ndihmës sociale në Kosovë, si dhe Udhëzimin Administrativ nr. 04/2013 mbi procedurat për dorëzimin e kërkesave për ndihmë sociale.

Në ndihmën sociale janë përfshirë dy kategori: kategoria e parë (I) dhe kategoria e dytë (II). Numri i familjeve që marrin ndihmë sociale ndryshon sipas sezonit – gjatë verës numri zvogëlohet, ndërsa gjatë dimrit rritet. Përdoruesit e ndihmës sociale i përkasin komuniteteve shqiptar, goran dhe boshnjak. Ne gjithmonë kemi punuar në bashkëpunim me Departamentin për Ndhmë Sociale, ku jemi konsultuar për çdo problem.

Vlen të theksohet se gjatë këtij periudhe kemi bashkëpunuar edhe me Kuvendin e Komunës – Drejtoritë për Kadastrën dhe Gjeodezinë, Administratën, Arsimin, Zyrën e Punësimin, Kryqin e Kuq të Kosovës, Bashkësinë Islame në Dragash dhe KFOR-in Turk.

Qendra për Punë Sociale gjatë këtij viti ka ndihmuar shumicën e personave në nevojë sociale në rehabilitimin dhe zgjidhjen e problemeve që kanë qytetarët e komunës. Kryetari i Komunës së Dragashit ka ndihmuar institucionin STREHIMORE PËR GRA DHE FËMIJË – SHTËPI E SIGURT – PRIZREN, ku strehohen viktimat të dhunës në familje dhe viktimat të trafikimit të qenieve njerëzore, me një mbështetje prej 1,700 €, i cili kujdeset gjithashtu për fëmijë të braktisur, fëmijë pa të dy prindërit, fëmijë të keqtrajtuar, maltretuar dhe të neglizhuar.

Gjatë këtij viti kemi themeluar gjithashtu edhe Organin e Kujdestarisë

## NUMRI I NDIHMAVE SOCIALE NË BAZA MUJORE DHE SHUMA PËR VITIN 2025

Muaji	Numri i familjeve
Janar	289
Shkurt	291
Mars	283
Prill	269
Maj	265
Qershor	268
Korrik	268
Gusht	269
Shtator	269
Tetor	268
Nëntor	271
Dhjetor	274

Në komisionin mjekësor janë pranuar **231** raste, nga të cilat **225** janë miratuar.

Gjatë këtij viti kemi pasur **2** ankesa ku njëra është miratuar dhe një është refuzuar.

Shuma e taksave komunale për shërbimet e ofruara nga QPS-ja në vitin 2025 është **536 €**.

Në këtë raport do të përmbledhim aktivitetet e Qendrës për Punë Sociale (QPS) në lidhje me pilot projektin e reformës së asistencës sociale (SAS). Pilotimi SAS është një iniciativë e Qeverisë së Republikës së Kosovës e zbatuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) dhe Qendrat për Punë Sociale me qëllim të identifikimit dhe mbështetjes së familjeve më të varfra në vend dhe ndihmë në miratimin e Ligjit të ri për Ndhmën Sociale.

Pilot projekti i reformës SAS synon të mbështesë 6000 familje të varfra në Kosovë. Ky proces synon të testojë dhe zbatojë metoda të reja për vlerësimin e varfërisë dhe mbështetjen e familjes, duke përfshirë:

1. Testi i mjeteve financiare (TMF) – Vlerëson të ardhurat formale të familjeve
2. Testi i pasurisë (TP) - Vlerëson pronësinë e aseteve të familjes dhe
3. Testi i Mjeteve të Përafërta (TMP) – Analizon nivelet e përgjithshme të mirëqenies së familjes.

Element thelbësor i kësaj Reforme është DIGJITALIZIMI i procesit të aplikimit përmes platformës E-Kosova, e cila sjell një grup të ri kriteresh të përshtatshmërisë për familjet që mund të përfitojnë nga

skema, kriteret e mëparshme dy kategorit do të hiqen dhe vetëm kriteri i të ardhurave materiale do të përfitojë familjet në kushte më të vështira ekonomike.

Në këtë pilot projekt SAS, QPS verifikoi familjet në zonën ku banojnë sipas listës së ofruar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, gjithsej 375 familje,

Roli i QPS-së ishte të vlerësonte vetëm gjendjen e përafërt financiare (TMF), kështu që nga Maji deri në Nëntor kemi vizituar 208 familje në terren, kemi kryer verifikimin, kemi futur të dhënat në bazën e të dhënave për verifikim të mëtejshëm nga Ministria që ka përpunuar aplikimet familjare, ku pas gjithë këtyre kontrolleve, 63 familje kanë përfituar nga kjo platformë e re.



*Republika e Kosovës*  
*Republika Kosova / Republic of Kosovo*  
*Komuna e Dragashit / Opština Dragaš / Dragash Municipality*  
*Drejtoria për Kulturë, Rini e Sport*

---



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
Komuna e Dragashit  
Opština Dragaš

QR Nr. Br. 052/02-3744/26  
02.08.2016  
Dragash - Dragaš

**RAPORTI I PUNËS PËR PERIUDHËN JANAR - DHJETOR 2025**

*Dhjetor 2025*

## ***Përmbledhje***

Ky raport vjetor paraqet përmbledhjen e veprimtarisë së Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport të Komunës së Dragashit për periudhën Janar - Dhjetor 2025, i hartuar sipas formatit standard të raportimit komunal. Raporti ka për qëllim informimin lidhur me realizimin e planit vjetor të punës, zbatimin e kompetencave ligjore dhe institucionale, si dhe identifikimin e sfidave dhe nevojave për periudhën e ardhshme.

Gjatë vitit 2025, Drejtoria ka ushtruar aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi, strategjitë komunale dhe vendimet e Kuvendit Komunal, duke u fokusuar në tri fusha kryesore: kulturë, rini dhe sport. Në këtë kuadër, janë realizuar aktivitete kulturore, rinore e sportive, janë mbështetur iniciativa dhe projekte të ndryshme, si dhe është siguruar funksionimi i institucioneve dhe shërbimeve që veprojnë në kuadër të drejtorisë.

Raporti pasqyron nivelin e realizimit të aktiviteteve të planifikuara, bashkëpunimin me institucionet arsimore, shoqatat kulturore e sportive, organizatat rinore dhe partnerët tjerë relevantë, me synim rritjen e pjesëmarrjes qytetare dhe përfshirjen aktive të të rinjve në jetën kulturore dhe sportive të komunës.

Raporti paraqet një pasqyrë të punës së Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport gjatë vitit 2025 dhe shërben si udhërrëfyes për planifikimin e aktiviteteve dhe prioritetëve të vitit të ardhshëm, duke synuar avancimin e aktiviteteve dhe politikave komunale në fushat e kulturës, rinisë dhe sportit.

Në kuadër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRS) vepron sektori i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i cili ka një rol kyç në organizimin, zhvillimin dhe promovimin e aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive në komunë. Për vitin 2025, bazuar në planin e punës të paraqitur dhe të miratuar nga Asambleja Komunale, DKRS ka ndërmarrë një sërë iniciativash dhe ka bërë përpjekje maksimale për realizimin e të gjitha objektivave të përcaktuara.

### **1. Zbatimi i planit dinamik të aktiviteteve**

Gjatë kësaj periudhe raportuese, DKRS ka synuar të zbatojë në mënyrë efikase planin dinamik të aktiviteteve, duke garantuar pjesëmarrje të gjerë të qytetarëve dhe promovimin e vlerave kulturore, sportive dhe rinore. Në këtë drejtim:

- **Shënimi i festave kombëtare** ka qenë një prioritet kryesor, duke organizuar manifestime përkujtimore, akademi solemne dhe aktivitete të tjera me pjesëmarrje të gjerë të qytetarëve dhe institucioneve lokale.
- **Promovimi i kulturës dhe trashëgimisë** është realizuar përmes organizimit të festivaleve, ekspozitave artistike dhe aktiviteteve letrare, me synim ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit kulturor.
- **Fuqizimi i rinisë** ka qenë një element i rëndësishëm, duke mbështetur iniciativa edukative, trajnime dhe projekte inovative që nxisin angazhimin dhe zhvillimin e tyre profesional.

- **Zhvillimi i sportit dhe aktiviteteve rekreative** është mbështetur përmes organizimit të garave sportive, turneve lokale dhe mbështetjes së klubeve sportive, përmirësimin e infrastrukturës dhe krijimin e kushteve sa më të mira në realizimin e garave sportive dhe aktiviteteve rekreative.

## **2. Bashkëpunimi dhe angazhimi**

DKRS ka realizuar bashkëpunime të frytshme me institucione të ndryshme dhe organizata lokale e ndërkombëtare për të mbështetur projektet e saj. Gjatë kësaj periudhe:

- Është thelluar bashkëpunimi me institucionet arsimore për organizimin e aktiviteteve edukative dhe kulturore.
- Janë zhvilluar partneritete me organizatat e shoqërisë civile për të rritur ndikimin e projekteve në komunitet.
- Është forcuar mbështetja për klubet sportive dhe grupet artistike, duke u ofruar mbështetje logjistike dhe financiare për realizimin e aktiviteteve të tyre.
- Janë organizuar trajnime dhe seminare për të rinjtë dhe sportistët, me qëllim zhvillimin e aftësive dhe përgatitjen e tyre për gara dhe aktivitete sportive.

## **3. Ndikimi në komunitet dhe sfidat**

Angazhimi i DKRS ka ndikuar pozitivisht në komunitetin lokal, duke krijuar një ambient më aktiv dhe të pasur në aspekte kulturore dhe sportive. Përveç arritjeve, gjatë kësaj periudhe janë identifikuar edhe disa sfida, të tilla si:

Nevoja për përmirësimin e mëtejshëm të infrastrukturës kulturore dhe sportive.

- Sigurimi i burimeve të qëndrueshme financiare për organizimin e aktiviteteve më të mëdha dhe më gjithëpërfshirëse.
- Rritja e angazhimit të të rinjve në aktivitetet kulturore dhe sportive, duke krijuar mekanizma të rinj për pjesëmarrje më aktive.

## **4. Konkluzion dhe vizioni për të ardhmen**

DKRS mbetet e përkushtuar në realizimin e aktiviteteve të saj me qëllim promovimin dhe zhvillimin e kulturës, sportit dhe rinisë. Në të ardhmen, fokusi do të jetë në:

- Rritjen e numrit të aktiviteteve kulturore, rinore e sportive me ndikim më të madh në komunitet.
- Mbështetjen e sportit për të gjitha grup moshat, me synim rritjen e pjesëmarrjes dhe përmirësimin e kushteve për zhvillim profesional.
- Zgjerimin e bashkëpunimeve me organizata kombëtare dhe ndërkombëtare për të sjellë projekte të reja dhe mundësi të reja për të rinjtë dhe komunitetin e gjerë.

Më poshtë, në mënyrë tabelore, po paraqesim një pasqyrë të detajuar të aktiviteteve të realizuara, së bashku me angazhimet e përgjithshme të DKRS gjatë kësaj periudhe raportuese.

**Tabela e aktiviteteve të organizuara për periudhën Janar - Dhjetor 2025**

<b><i>Aktivitetet e organizuara dhe të mbështetura nga DKRS</i></b>	<b><i>Përshkrimi i aktivitetit</i></b>	<b><i>Muaji</i></b>
<b><i>Flaka e Janarit</i></b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Orë letrare me nxënësit e Shkollës së Mesme "Ruzhdi Berisha" dhe ese në të gjitha shkollat fillore, në kujtim dhe nderim të jetës, veprës dhe sakrificës së heronjve Jusuf e Bardhosh Gërvalla dhe Kadri Zeka. Kjo ngjarje synon të frymëzojë brezat e rinj përmes fuqisë së fjalës artistike dhe reflektimit mbi kontributin e tyre në rrugën drejt lirisë. Nxënësit do të kenë mundësinë të shprehin ndjenjat dhe mendimet e tyre përmes poezisë, prozës dhe eseve, duke mbajtur gjallë kujtimin dhe mesazhin e heronjve të kombit.</li> </ul>	<b><i>Janar</i></b>
<b><i>17 Shkurti - Dita e Pavarësisë</i></b>	<p>Me rastin e 17 Shkurtit, Ditës së Pavarësisë së Kosovës, u organizuan një sërë aktiviteteve perkujtimore, artistike dhe sportive për të nderuar sakrificën e atyre që kontribuan në lirinë dhe pavarësinë e vendit tonë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <b>Seancë Solemne</b> – U mbajt një seancë solemne me pjesëmarrjen e përfaqësuesve institucionalë, veteranëve të luftës, familjarëve të dëshmorëve dhe qytetarëve. Gjatë kësaj seance u mbajtën fjalime perkujtimore mbi rrugëtimin historik të Kosovës drejt pavarësisë dhe rëndësinë e kësaj dite për kombin tonë.</li> <li>▪ <b>Homazhe dhe vendosja e kurorave me lule</b> – U zhvilluan ceremoni perkujtimore për nder të heronjve dhe dëshmorëve të kombit, ku u vendosën kurora me lule tek: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shtatorja e Komandantit Legjendar Adem Jashari,</li> <li>• Varrezat e Dëshmorëve në Dragash,</li> <li>• Varrezat e Dëshmorëve në fshatin Buçe.</li> </ul> </li> <li>▪ <b>Program artistik dhe kulturor</b> – U realizua program artistik për të shënuar Ditën e Pavarësisë me pjesëmarrjen e SHKA "Bresana" dhe këngëtarëve të mirënjohur me interpretime muzikore dhe valle tradicionale.</li> </ul>	<b><i>Shkurt</i></b>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <b>Aktivitete sportive në kuadër të shënimit të Ditës së Pavarësisë:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Turniri i futbollit me nxënësit e të gjitha shkollave</li> <li>• Turniri i futbollit me mësuesit e të gjitha shkollave</li> <li>• Turniri i volejbollit me vajzat e shkollës së mesme “Ruzhdi Berisha”</li> </ul> </li> </ul> <p>Të gjitha këto aktivitete u zhvilluan në një atmosferë festive dhe përkujtimore, duke përçuar mesazhin e unitetit, krenarisë dhe përkushtimit ndaj vlerave kombëtare. 17 Shkurti u festua me dinjitet dhe madhështi, duke reflektuar mbi sakrificën dhe arritjet e popullit të Kosovës në rrugën drejt lirisë dhe shtetndërtimit.</p>	
<i><b>Epopeja e UÇK-së</b></i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Seancë Solemne, vendosja e kurorave tek shtatorja e Komandantit Legjendar Adem Jashari, varrezat e Dëshmorëve në Dragash e në fshatin Buçe.</li> </ul>	<i><b>Mars</b></i>
<i><b>Festivali “Hasi Jehon”</b></i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ SHKA”Bresana” me sukses ka prezantuar vlerat kulturore nga komuna jonë.</li> </ul>	<i><b>Maj</b></i>
<i><b>5 Maji - Dita e Dëshmorëve të Atdheut</b></i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Seancë Solemne, vendosja e kurorave tek shtatorja e Komandantit Legjendar Adem Jashari, varrezat e Dëshmorëve në Dragash e në Buçe</li> <li>▪ Program artistik</li> <li>▪ Aktiviteti është realizuar në bashkëpunim me OVL të UÇK-së - Dega në Dragash</li> </ul>	<i><b>Maj</b></i>
<i><b>1 Qershori – Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve</b></i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Program artistik me fëmijë dhe nxënës të të gjitha shkollave të komunës tonë</li> </ul>	<i><b>Qershor</b></i>
<i><b>“Sofra e Ymer Prizrenit” - Zgatar</b></i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Manifestimi tradicional "Sofra e Ymer Prizrenit", i organizuar në fshatin Zgatar në bashkëpunim me OJQ ” KROI I MACES”.</li> </ul>	<i><b>Qershor</b></i>
<i><b>Festivali Folklorik “ I këndojmë Lirisë” - Klinë</b></i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ SHKA”Opoja” me sukses te plotë ka prezantuar vlerat kulturore e artistike të komunës tonë</li> </ul>	<i><b>Qershor</b></i>

<p><b>Festivali Folklorik Mbarëkombëtarë "Hani i Elezit"</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ SHKA "Bresana" me sukses ka prezantuar vlerat kulturore e artistike të komunës tonë dhe është shpërblyer me vendin e dytë</li> </ul>	<p><b>Qershor</b></p>
<p><b>Dita e Çlirimit të Komunës</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Ndeshje volejboli me përballje mes ekipeve te grave te punësuar e organizuar nga Grupi i Grave Asambleiste e mbajtur ne Sallën e Edukatës Fizike në Brodosanë.</li> <li>▪ Ndeshje volejboli me përballje mes ekipeve te grave te punësuar e organizuar nga Grupi i Grave Asambleiste e mbajtur ne Sallën e Edukatës Fizike në SHML "Ruzhdi Berisha" në Dragash.</li> <li>▪ Seancë Solemne ,vendosja e kurorave tek Shtatorja e Komandantit Legjendar Adem Jashari, Varrezat e Dëshmorëve në Dragash e në fshatin Buçe.</li> <li>▪ Ceremonia e nderimit të pensionistëve ( administrata, arsimi e shëndetësia )</li> <li>▪ Program artistik me SHKA "Bresana" dhe këngëtarë të mirënjohur.</li> <li>▪ Gara tradicionale e vrapimit të kuajve e realizuar në bashkëpunim me Klubin e Kuajve "OPOJA".</li> <li>▪ Marshi i Çiklizmit i realizuar ne bashkëpunim me Klubin e Çiklizmit "Opoja"</li> <li>▪ Meetingu i motocross në bashkëpunim me Klubin e Motoristëve "ENDURO SHARRI" me pjesëmarrje të klubeve nga tw gjitha komunat e Kosovës.</li> <li>▪ Turneu " Sharri 5v5" i realizuar në bashkëpunim me Klubin" Sport Sharri". Aktiviteti ka bashkuar të rinj nga gjithë rajoni në një platformë moderne të komunikimit, logjikës strategjike dhe frymës ekipore.</li> </ul>	<p><b>Qershor</b></p>
<p><b>Festivali Mbarëkombëtar i Valles Dyshe "Dyshja na Bashkon" - Prishtinë</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ SHKA "Bresana" me sukses te plotë paraqiti vallet autoktone te komunës tonë ku u shpërblye me vendin e dytë dhe Çmimin Special te Festivalit.</li> </ul>	<p><b>Korrik</b></p>
<p><b>Festivali i Senovës në Slloveni dhe Festivali i Samoborit në Kroaci - Festival i përbashkët shumëkombësh</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ SH.K.A. "Bresana" ka përfaqësuar me dinjitet pasurinë etnografike të Komunës së Dragashit përmes valleve tradicionale, kostumeve autentike dhe këngëve burimore.</li> </ul>	<p><b>Korrik</b></p>

<p><b>ETNO FEST - Festivali i Arteve dhe Kulturës Tradicionale - Prishtinë</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ SHKA "OPOJA" me shume sukses ka prezantuar me këngë e valle nga komuna jonë në këtë festival me pjesëmarrje të gjerë të artistëve shqiptar e ndërkombëtar.</li> <li>SHKA "OPOJA" me pjesëmarrjen e saj solli një rrëfim të gjallë, një udhëtim ndër breza, përmes traditave të ndryshme, të ndërthurura në ritme që tejkalojnë kufijtë e gjeografisë dhe kohës.</li> </ul>	<p><b>Korrik</b></p>
<p><b>Kamping dy ditor - Brod</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Ne bashkëpunim me OJQ "AVOKO" u mbajt një kamping dyditor i organizuar me pjesëmarrje të të rinjve nga Dragashi dhe komuna të tjera të Kosovës me qëllim të promovimit të vlerave turistike e kulturore të komunës tonë.</li> </ul>	<p><b>Korrik</b></p>
<p><b>Festivali Ballkanik i Folklorit të Valleve "Opoja Vallëzon"</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Festivali ka zgjatur tre ditë dhe është realizuar në bashkëpunim me SHKA "BRESANA".</li> <li>▪ Ansamblet dhe Shoqëritë kulturo-artistike që përformuan ishin nga Kosova, Shqipëria, Turqia, Bullgaria, Qiproja Veriore, Maqedonia e Veriut, Bosnja dhe Hercegovina, Polonia e Spanja.</li> </ul>	<p><b>24-25 -26 Korrik</b></p>
<p><b>"Ditët e Mërgatës" – Bellobrad</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Turne në futboll me pjesëmarrje të ekipeve të fshatrave i realizuar me OJQ "AVOKO"</li> </ul>	<p><b>28-29-30 Korrik</b></p>
<p><b>"Ditët e Mërgatës" - Liqeni i Breznës</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Manifestim kulturor dhe sportiv i organizuar në Liqenin e Breznës me pjesëmarrje të bashkatdhetarëve të të gjitha grupmohave, realizuar në bashkëpunim me SHKA "OPOJA"</li> </ul>	<p><b>Gusht</b></p>
<p><b>"Ditët e Mërgatës" – Dragash</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Manifestim kulturor i organizuar në Dragash me pjesëmarrje të bashkatdhetarëve të të gjitha grupmohave, realizuar në bashkëpunim me OJQ "DEMOKRATSKA OMLADINA GORE"</li> </ul>	<p><b>Gusht</b></p>
<p><b>"Ditët e Mërgatës" – Kosce</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Manifestim kulturor i organizuar me pjesëmarrje të bashkatdhetarëve të të gjitha grupmohave, realizuar në bashkëpunim me OJQ "BISER"</li> </ul>	<p><b>Gusht</b></p>
<p><b>"Ditët e Mërgatës" - Restelicë</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Manifestim kulturor i organizuar pjesëmarrje të bashkatdhetarëve të të gjitha grupmohave, realizuar në bashkëpunim me OJQ "EMKACBEND"</li> </ul>	<p><b>Gusht</b></p>

<b>“Ditët e Mërgatës” – Brod</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Organizim sportiv në ecje nëpër bjeshkë të fshatit Brod me pjesëmarrje të bashkatdhetarëve të të gjitha grupmohave i realizuar në bashkëpunim me OJQ”MILJINA”</li> </ul>	<b>Gusht</b>
<b>“Ditët e Mërgatës” – Bellobrad</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Manifestim kulturor i organizuar në Bellobrad pjesëmarrje të bashkatdhetarëve të të gjitha grupmohave. Aktiviteti u realizua në bashkëpunim me OJQ”QENDRA”</li> </ul>	<b>Gusht</b>
<b>Ditët e Mërgatës – Restelicë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Turne në futboll me pjesëmarrje të ekipeve të fshatrave i realizuar në bashkëpunim me OJQ <b>”INTER KLUB SPORT”</b></li> </ul>	<b>Gusht</b>
<b>Ditët e Mërgatës</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Manifestim kulturor i realizuar në bashkëpunim me OJQ”STARS”</li> </ul>	<b>Gusht</b>
<b>Festivali në Bursa - Turqi</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>SH.K.A. “Bresana” ka përfaqësuar me dinjitet pasurinë etnografike të Komunës së Dragashit përmes valleve tradicionale, kostumeve autentike dhe këngëve burimore.</li> </ul>	<b>Shtator</b>
<b>Vrapimi i gjeneratës 2008</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Aktivitet sportiv i organizuar me gjeneratën e vitit 2008 qe përkon me vitin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës</li> </ul>	<b>Tetor</b>
<b>Festivali “Balkan Fest” - Kumanovë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>SHKA”Bresana” me sukses ka prezantuar vlerat kulturore e artistike të komunës tonë dhe është shpërblyer me vendin e dytë</li> </ul>	<b>Nëntor</b>
<b>Festivali Folklorik Mbarëkombëtar” Kamenica Festë ” - Kamenicë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>SHKA”Bresana” me sukses ka prezantuar vlerat kulturore e artistike të komunës tonë dhe është shpërblyer me vendin e parë</li> </ul>	<b>Nëntor</b>
<b>28 Nëntori – Dita e Flamurit Kombëtar</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Seancë Solemne ,vendosja e kurorave tek Shtatorja e Komandantit Legjendar Adem Jashari, Varrezat e Dëshmorëve në Dragash e në fshatin Buçe.</li> <li>Aktivitete kulturore me nxënësit e SHFMU”28 Nëntori” në Brodosanë</li> </ul>	<b>Nëntor</b>
<b>Tryezë me të rinj</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>“Edukimi, kultura dhe teknologjia në jetën e të rinjve” - organizuar në bashkëpunim me OJQ”AVOKO”</li> </ul>	<b>Dhjetor</b>

Në mbështetje të Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L222 dhe Ligjit Nr. 04/L-116 nenin 58, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L040, nenit 5,7 dhe 8 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Drejtoria për Kulturë, Rini e Sport, bazuar në Thirrjet Publike nga DKRS dhe Vendimet e Kryetarit të Komunës ka bërë subvencionimin e OJQ-ve, ku përfitues ishin:

<i>Nr.</i>	<i>Emri i OJQ-së</i>	<i>Emri i projektit</i>	<i>Shuma</i>
<b><i>NË FUSHËN E SPORTIT</i></b>			
<b><i>1.</i></b>	<b><i>KLUBI I KUAJVE "OPOJA"</i></b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përkrahja për sportistët kulmorë dhe klubet sportive</li> <li>- Ngritja e nivelit profesional të klubeve sportive dhe shkollave të sportit për grup moshat e reja</li> </ul>	<b><i>7.000€</i></b>
<b><i>2.</i></b>	<b><i>KLUBI I SHAHUT "SHARRI"</i></b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përkrahja për sportistët kulmorë dhe klubet sportive</li> <li>Ngritja e nivelit profesional të klubeve sportive dhe shkollave të sportit për grup moshat e reja</li> </ul>	<b><i>4.000€</i></b>
<b><i>3.</i></b>	<b><i>SHKOLLA E FUTBOLLIT "FC DRAGASH"</i></b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përkrahja për sportistët kulmorë dhe klubet sportive</li> <li>Ngritja e nivelit profesional të klubeve sportive dhe shkollave të sportit për grup moshat e reja</li> </ul>	<b><i>6.000€</i></b>
<b><i>4.</i></b>	<b><i>SHKOLLA E FUTBOLLIT "AROMA"</i></b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përkrahja për sportistët kulmorë dhe klubet sportive</li> <li>Ngritja e nivelit profesional të klubeve sportive dhe shkollave të sportit për grup moshat e reja</li> </ul>	<b><i>4.500€</i></b>

5.	<b>KLUBI I FUTBOLLIT "OPOJA"</b>	- Përkrahja për sportistët kulmorë dhe klubet sportive Ngritja e nivelit profesional të klubeve sportive dhe shkollave të sportit për grup moshat e reja	<b>21.500€</b>
6.	<b>KLUB SPORT "SHARRI"</b>	- Përkrahja për sportistët kulmorë dhe klubet sportive - Ngritja e nivelit profesional të klubeve sportive dhe shkollave të sportit për grup moshat e reja	<b>4.500€</b>
7.	<b>KLUBI I SKITARISË "ARXHENA"</b>	- Përkrahja për sportistët kulmorë dhe klubet sportive - Ngritja e nivelit profesional të klubeve sportive dhe shkollave të sportit për grup moshat e reja	<b>2.000€</b>
8.	<b>KLUBI I MOTORRISTËVE "ENDURO SHARRI"</b>	- Përkrahja për sportistët kulmorë dhe klubet sportive - Ngritja e nivelit profesional të klubeve sportive dhe shkollave të sportit për grup moshat e reja	<b>5.500€</b>
9.	<b>KLUBI I ÇIKLIZMIT "OPOJA"</b>	- Përkrahja për sportistët kulmorë dhe klubet sportive - Ngritja e nivelit profesional të klubeve sportive dhe shkollave të sportit për grup moshat e reja	<b>1.500€</b>
10.	<b>KLUBI I BASKETBOLLIT "SHARRI"</b>	- Përkrahja për sportistët kulmorë dhe klubet sportive - Ngritja e nivelit profesional të klubeve sportive dhe shkollave të sportit për grup moshat e reja	<b>1.000€</b>
<b>Gjithsejtë në fushën e sportit:</b>			<b>57.500€</b>
<b>NË FUSHËN E KULTURËS</b>			
1.	<b>NVO"INTER KLUB SPORT" RESTELICË</b>	- Ditët e mërgatës	<b>4.500€</b>

2.	<b>SHKA "OPOJA"</b>	- Ditët e mërgatës	<b>6.000€</b>
3.	<b>NVO"EMKACBEND"- RESTELICË</b>	- Ditët e mërgatës	<b>4.000€</b>
4.	<b>DFD"BISER"-RESTELICË</b>	- Ditët e mërgatës	<b>4.000€</b>
5.	<b>OJQ"QENDRA"- DRAGASH</b>	- Ditët e mërgatës	<b>4.000€</b>
6.	<b>NVO"MILJINA"- BROD</b>	- Ditët e mërgatës	<b>3.000€</b>
7.	<b>NVO"STARS"- RADESHË</b>	- Ditët e mërgatës	<b>5.000€</b>
8.	<b>NVO"DEMOKRATSKA OMLADINA GORA"DRAGASH</b>	- Ditët e mërgatës	<b>5.000€</b>
9.	<b>SHKA"BRESANA" BRESANË</b>	- Festivali Ballkanik i Folklorit të Valleve " Opoja Vallëzon"	<b>34.000€</b>
10.	<b>SHAKA"BRESANA" BRESANË</b>	- Manifestimet e komunës, ruajtja e folklorit, promovimi i vlerave kulturore dhe pjesëmarrja në festivale brenda e jashtë Kosovës	<b>11.000€</b>
<b>Gjithsejtë në fushën e kulturës:</b>			<b>80.500€</b>
<b>NË FUSHËN E RINISË</b>			
1.	<b>OJQ"AVOKO"</b>	- Mbështetja dhe fuqizimi i organizatave rinore në zhvillimin e aktiviteteve specifike për të rinjtë që ndikon drejtpërsëdrejti në nxitjen e aktiviteteve në fusha të ndryshme	<b>9.000€</b>
<b>Gjithsejtë në fushën e rinisë:</b>			<b>9.000€</b>
<b>SHUMA E PËRGJITHSHME E SUBVENCIONEVE NË FUSHËN E KULTURËS, RINISË E SPORTIT:</b>			<b>147.000€</b>

### Investimet kapitale në kuadër të DKRS

Nr.	Investimet kapitale
1.	Ndërtimi i stadiumit të qytezës së Dragashit - investim i realizuar në mes të Komunës së Dragashit dhe Federatës së Futbollit të Kosovës.
2.	Ndërtimi i zhveshtoreve dhe vendosja e kontejnerëve ne stadiumin e qytetit në Dragash
3.	Ndërtimi i stadiumit në fshatin Restelic
4.	Ndërtimi i stadiumit-Blaq vazhdimësia e investimeve- projekt 3- vjeçar

### Bibliotekat

Gjatë periudhës raportuese Janar - Dhjetor 2025, Biblioteka Publike “Ymridin Qengaj” në Dragash, së bashku me degët nëpër fshatra, ka ushtruar veprimtarinë e saj në përputhje me rregulloren dhe legjislacionin në fuqi për bibliotekat.

Në këtë periudhë janë realizuar këto aktivitete kryesore:

- Përpunimi profesional i librave të rinj;
- Klasifikimi dhjetor universal;
- Anëtarësimi dhe regjistrimi i lexuesve në bibliotekën qendrore dhe në degë;
- Regjistrimi dhe përditësimi i inventarit bibliotekar;
- Heqja nga qarkullimi e librave të dëmtuar, të amortizuar ose të papërdorur për një kohë të gjatë, në përputhje me rregulloren përkatëse;
- Mirëmbajtja dhe sistemimi i fondit libror ekzistues.

Gjatë gjithë vitit janë zhvilluar takime mujore me zyrtarët e bibliotekave, me qëllim rritjen e efikasitetit të punës dhe koordinimit më të mirë institucional. Po ashtu, janë realizuar bashkëpunime dhe takime me shkollat fillore nëpër fshatra, me synim nxitjen e leximit dhe afrimin e nxënësve me bibliotekën.

Çdo vit paraqet sfida të reja për funksionimin e bibliotekave, veçanërisht për shkak të rënies së interesimit për anëtarësim nga ana e lexuesve. Megjithatë, pavarësisht këtyre vështirësive, stafi i bibliotekës ka vazhduar me përkushtim përmbushjen e detyrave themelore, si:

- Anëtarësimi i lexuesve;
  - Përpunimi dhe klasifikimi i librave të rinj;
  - Hartimi i regjistrave për pasurimin dhe freskimin e fondit libror;
  - Heqja e librave të dëmtuar nga raftet;
  - Ruajtja dhe mirëmbajtja e librave ekzistues.
- Të gjitha këto detyra janë realizuar me sukses, në përputhje me mundësitë dhe kapacitetet aktuale.

Raporti i detajuar në formë tabelore.

## **Lexuesit dhe librat e lexuara sipas përbërja sociale**

### ***Biblioteka amë***

Në bibliotekën amë	Nxënës	Studentë	Punëtorë/e	Bujq	Amvise	Të tjerë	Gjithsej
Numri i lexuesve	367	3	105	2	///	77	554
Numri i librave të lexuara	548	10	138	3	///	90	789

### ***Në degë***

Numri i lexuesve	447	///	///	///	///	///	Gjithsej 447
Numri i librave të lexuara	664	///	///	///	///	///	664

### ***Amë dhe degë***

Numri i lexuesve	814	3	105	2	///	77	Gjithsej 1001
Numri i librave të lexuara	1212	10	138	3	///	90	1453

### ***Lexuesit dhe librat e lexuara sipas përbërjes nacionale***

Në bibliotekën amë	Shqiptarë	Serbë	Boshnjakë	Goran	Të tjerë	Gjithsej
Numri i lexuesve	434	///	9	109	///	552
Numri i librave të lexuara	625	///	13	148	///	786

**Në degë**

Numri i lexuesve	477	///	///	///	///	477
Numri i librave të lexuara	664	///	///	///	///	664

**Amë dhe degë**

Numri i lexuesve	911	///	9	///	///	920
Numri i librave të lexuara	1289	///	13	///	///	1302

**Fondi librar në biblioteka amë**

Në gjuhën	Shqipe	Serbe	Turke	Të tjerë	Gjithsej
	11871	11138	146	622	<b>23777</b>

**Fondi librar në degë**

Nr.	Degët	Shqipe	Serbe	Turke	Tjerë	Gjithsej
1.	Biblioteka publike - dega në Bresanë	7776	439	///	170	8385
2.	Biblioteka publike - dega Bellobrad	5760	///	///	22	5782
3.	Biblioteka publike - dega Brezne	7575	///	///	23	7598
4.	Biblioteka publike - dega Krushevë	298	4784	44	175	5301
5.	Biblioteka publike - dega Brod	22	5003	79	169	5273
6.	Biblioteka publike - dega Blaç	4480	///	///	///	4480
		<b>25911</b>	<b>10226</b>	<b>123</b>	<b>559</b>	<b>36819</b>

**Fondi librar amë dhe degë**

Në gjuhën	Shqipe	Serbe	Turke	Të tjera	Gjithsej
	<b>37782</b>	<b>21364</b>	<b>269</b>	<b>1181</b>	<b>60596</b>

Krahas realizimit të aktiviteteve të parapara me planin e punës, drejtoresha e DKRS ka pas një bashkëpunim të vazhdueshëm me Ministrinë e Kulturës, Rinisë e Sportit dhe shumë organizata të tjera ku janë dorëzuar edhe shumë kërkesa për mbështetje materiale në të gjithë sektorët duke përfshirë edhe bibliotekat, muzeun etnografik dhe restaurimin e objekteve të trashëgimisë kulturore e historike. Gjithashtu në vazhdimësi ka marrë pjesë në mbledhjet e Qeverisjes Komunale, Mekanizmin Komunal Kundër Dhunës në familje, takimet publike, takime me përfaqësues të federatave të sportit e klube sportive si dhe organizata rinore.

Drejtorja ka ofruar raporte për Kryetarin e Komunës, informata për Kuvendin Komunal, komitetet përkatëse, Ministrinë Kulturës, Rinisë e Sportit, organizatat vendore e ndërkombëtare.

Me rastin e organizimit të aktiviteteve Drejtorja ka pasur mbështetje edhe nga partnerë të tjerë si: Policia e Kosovës, Ministria për Kulturë Rini dhe Sport, dhe disa OJQ lokale që kanë ndikuar në masë të madhe në numrin e aktiviteteve, suksesin dhe kualitetin e tyre.

**Drejtorja për Kulturë, Rini e Sport**

**Drejtoresha**

**Liridona Misinaj**

